

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6869
E premte, 7 prill 2023
çmimi 0.40 €

Poshtërsia tjetër e Gjykatës Speciale ndaj Salih Mustafës

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYETARI I PRISHTINËS, PËRPARIM RAMA, DHE PËRFAQËSUES TË PARTIVE OPOZITARE, JANË SHPREHUR TË SHQETËSUAR PAS INFORMATAVE SE MINISTRIA E FINANCAVE PO BLOKON BARTJEN E TË HYRAVE VETJAKE TË KOMUNAVE NGA VITET PARAPRAKE

FAQE 4-5

QEVERIA KURTI PO BLOKON BARTJEN E TË HYRAVE VETJAKE TË KOMUNAVE

Ministria e Financave po bllokoi bartjen e të hyrave vetjake të komunave nga vitet paraprake ka thënë të enjten kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, teksa i ka bërë thirrje ministrit të Financave, Hekuran Murati, që të mos bllokojë dhe urgjentisht të bëjë bartjen e të hyrave vetjake të Prishtinës. Përndryshe, siç ka thënë ai, do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve të Prishtinës. Ndërkaq partitë opozitare kanë theksuar se nuk do të ketë normalitet në Kuvend nëse tentohet të cenohet pavarësia e komunave



KOMUNA E PRISHTINËS
OPŠTINA PRISTINA
MUNICIPALITY OF PRISTINA

RRETHANAT AKTUALE NUK MUNDËSOJNË ZGJEDHJE TË LIRA DHE TË DREJTA NË VERI

FAQE 3



OPOZITA: PUNA E QEVERISË, ARBITRARE DHE ANTIKUSHTETUESE

FAQE 6



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



KELMENDI, GJAKOVA DHE KRASNIOI GRADOHEN ME TITULLIN KOLONELË NË USHTRINË SHQIPTARE

F. 14



Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

Endrit Shaqiri
+38344685122

INFINITY
Digital Agency
Internet Website,
Marketing...

Gjukanoviqi jep dorëheqje nga pozita e kryetarit të partisë DPS

PODGORICË, 6 PRILL - Lideri i Partisë Demokratike të Socialistëve (DPS) në Mal të Zi, Millo Gjukanoviç, ka dhënë dorëheqje nga pozita e kreut të partisë. Ai ka qenë disa herë president dhe kryeministër i këtij shteti. Shërbimi i Ballkanit i "Radios Evropa e Lirë" ka mësuar se Gjukanoviç ka njoftuar për

këtë vendim në një sesion të partisë në pasditen e së mërkurës dhe se një takim i kryesisë së partisë është caktuar për 6 prill, kur do të formalizohet vendimi. Gjukanoviç ka dhënë dorëheqje nga pozita e liderit të partisë vetëm tri ditë pasi ka humbur në zgjedhjet presidenciale ndaj Jakov

Millatoviçit nga Lëvizja Evropa Tani. Gjukanoviç ka qenë president i DPS-së prej vitit 1998, kur e ka marrë pushtetin nga presidenti paraprak Momir Bullatoviç. Gjukanoviç do të zëvendësohet si kryetar partie nga udhëheqësi aktual i klubit parlamentar të DPS-së, Daniel Zhivkoviç.



Zelensky thotë se Bahmuti ende kontrollohet nga forcat ukrainase

KIEV, 6 PRILL - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, tha se forcat ukrainase vazhdojnë ta mbajnë qytetin e vijës së frontit në lindje të Ukrainës, Bahmutin, pavarësisht prej pretendimeve ruse se e kanë kapur atë. Ai tha se një tërheqje e forcave ukrainase do të ishte e mundur nëse kjo do ta nënkuptonte shpëtimin e trupave ukrainase. "Gjëja më e rëndësishme për mua është të mos humbasim ushtarët tanë", tha ai, duke shtuar se në rast se trupat ukrainase do të rrethohen, "do të merren vendimet përkatëse të sakta". Qyteti i Bahmutit dhe qytetet përreth të rajonit industrial lindor

të Donjeckut kanë qenë caku qendror i sulmeve gjatë 13 muajve që kur ka nisur lufta në Ukrainë. Më herët Ukraina ka thënë se kontrollimi i Bahmutit përbën "nevojë ushtarake". Rusia nisi pushtimin e përvokuar të Ukrainës më 24 shkurt 2022. Presidenti rus, Putin, e quan luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



Më shumë se 320 mijë refugjatë ukrainas në Çeki

PRAGË, 6 PRILL - Më shumë se 325 000 refugjatë të luftës nga Ukraina, me status të mbrojtur, janë aktualisht në Çeki, ka njoftuar Ministria e Brendshme e këtij shteti. Ata që kanë dëshiruar të qëndrojnë në këtë shtet të Bashkimit Evropian është dashur të regjistrohen në mënyrë elektronike deri në fund të marsit, ka thënë kjo ministri. Rezultatet kanë qenë në linjë me vlerësimet paraprake, është thënë në njoftim. Rreth 28 për qind e atyre që kanë kërkuar mbrojtje janë fëmijë, derisa 4 për qind janë të moshuar. Në mesin e të rriturve, shumica janë gra. Pjesa më e madhe e refugjatëve është thënë se janë duke qëndruar në Pragë, Bërno dhe Pëllzen. Në regjistrimin e fundit të



popullsisë, Çekia i ka pasur rreth 10.5 milionë banorë. Prej nisjes së luftës në Ukrainë, më 24 shkurt 2022, mbi gjysmë milioni

ukrainas kanë kërkuar mbrojtje të përkohshme në Çeki. Kjo nënkupton se prej atëherë rreth një e treta e tyre janë kthyer

në shtëpitë e tyre, ose janë nisur për në shtete të tjera. Ndërkohë, Ministria e Transportit në këtë shtet ka bërë me dije se

planifikon t'i regjistrojë të gjitha makinat ukrainase për një periudhë më të gjatë kohore. Në të ardhmen, pronari i makinës do të mund të identifikohet vetëm në bazë në tabelës me numrin e regjistrimit. Ky vendim është marrë pasi autoritetet kanë thënë se nuk janë duke mundur t'i gjobin vozitësit ukrainas, sidomos lidhur me parkingjet. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Ish-kryeministri Berlusconi shtrohet në spital

Romë, 6 prill - Ish-kryeministri italian Silvio Berlusconi u shtrua të mërkurën në spital, në reanimacion, për shkak të një problemi të lidhur me një infeksion të mëparshëm. Ministri italian i Shëndetësisë ka

njoftuar se Berlusconi ishte në gjendje të vetëdijshme dhe i aftë të fliste. 86-vjeçari, tri herë kryeministër i Italisë, është shtruar në spitalin San Raffaele të Milanos, klinika ku ai merr vazhdimisht trajtim mjekësor,

ka bërë me dije ministri i Jashtëm Antonio Tajani, i cili është, gjithashtu, udhëheqës i Partisë Forza Italia të Berlusconit. Për vite me radhë ai ka mbajtur një aparat që ndihmon

funksionimin e zezës. Në vitin 2016 ai iu nënshtrua një operacioni në zemër për ta zëvendësuar valvulin e aortës dhe ka mposhtur kancerin e prostatës. Në janar 2022 ai pati një infeksion në sistemin urinar.



Rrethanat aktuale nuk mundësojnë zgjedhje të lira dhe të drejta në veri



“Demokracia në Veprim” dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) kanë vlerësuar se në këto rrethana nuk ka kushte për mbajtje të zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës. Në anën tjetër, theksohet se veriu, për shkak të bojkotit, është shndërruar në shkretëtirë të veprimit institucional

EPOKA
ERE

Lirim GEÇI

PRISHTINË, 6 PRILL - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar listën përfundimtare të votuesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në katër komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok si dhe për dy kuvendet komunale, Zveçan dhe Leposaviq, të cilat do të mbahen më 23 prill.

“Demokracia në Veprim” ka bërë me dije se është duke i përcjellë në vazhdimësi zhvillimet lidhur me zgjedhjet në katër komunat veriore që janë paraparë të mbahen më 23 prill. Sipas DnV-së, përkundër shtyrjes së disahershme të ditës së zgjedhjeve dhe afateve për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre, subjektet politike, në veçanti ato të komunitetit serb, nuk kanë shprehur vullnet për të qenë pjesë e garës zgjedhore.

Madje në Mitrovicë të Veriut dhe Zubin Potok, ku komuniteti serb përbën mbi 90 për qind të popullsisë, nuk është regjistruar asnjë kandidat nga radhët e komunitetit serb.

DnV-ja vlerëson se kjo situatë mund ta cenojë legjitimitetin e

institucioneve që do të dalin nga zgjedhjet, pasi nuk garanton përfaqësim të drejtë të komunitetit serb. “Për shkak të dorëheqjeve të zyrtarëve zgjedhorë të komunitetit serb nga trupat menaxhuese zgjedhore, si dhe mungesës së interesimit të tyre për të aplikuar, KQZ-ja po përballlet me sfida në zhvillimin e përgatitjeve të nevojshme për të organizuar dhe administruar një proces të rregullt dhe të mirëfilltë zgjedhor. Paqartësitë lidhur me shfrytëzimin e qendrave ekzistuese të votimit, emërimin dhe trajnimin me kohë të komisionarëve, bartjen e materialeve zgjedhore janë disa nga problemet kyçe me të cilat pritet të ballafaqohen trupat menaxhuese të zgjedhjeve”, ka theksuar DnV-ja.

Sipas DnV-së, në përgjithësi situata e sigurisë në katër komunat veriore vijon të jetë e brishtë. Dorëheqjet e zyrtarëve policorë serbë në ato komuna përbëjnë handikap të madh në garantimin e sigurisë, veçanërisht gjatë procesit zgjedhor. “DnV rikujton që krijimi i një ambienti të sigurt është parakusht thelbësor për garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të drejta. Në anën tjetër, si

rezultat i këtyre faktorëve, mund të pritet një mungesë e theksuar e interesimit të qytetarëve të komunitetit serb për të marrë pjesë në zgjedhje. Kjo pritet të manifestohet edhe me dalje shumë të ulët në zgjedhje, që do ta cenojë legjitimitetin e institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet e 23 prillit. Andaj, marrë parasysh situatën e tanishme në terren, DnV vlerëson që rrethanat e tanishme nuk mundësojnë organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve në veri në përputhje me standardet për zgjedhje të lira dhe të drejta”, ka njoftuar DnV-ja. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) vlerëson se në këto rrethana nuk ka kushte për mbajtje të zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës, sipas ligjit dhe sipas standardeve minimale ndërkombëtare prandaj, sipas këtij institucioni, duhet të mendohet nëse ia vlen të bëhet një improvizim i mbajtjes së zgjedhjeve në këto kushte e që, pa asnjë dyshim, do të përsëriteshin shpejt. “Mundësia e vetme e mbajtjes së zgjedhjeve është harmonizimi i një marrëveshje politike, në nivelin më të lartë, ndonëse zgjedhjet janë çeshtje ekskluzivisht e brendshme e një shteti. Mirëpo, ky standard dhe

Kurti optimist për organizimin e zgjedhjeve në veri

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se institucionet janë duke bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme më 23 prill në katër komunat në veri të Kosovës: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

I pyetur nga deputetët e opozitës në seancën e Kuvendit të Kosovës, Kurti tha se janë ndarë mjetet e nevojshme për këtë proces dhe se askush nuk duhet dhe nuk mund ta cenojë të drejtën e qytetarëve për të zhvilluar një proces të rregullt zgjedhor. “Pluralizmi politik dhe, mbi të gjitha, e drejta e votimit lirshëm e pa pengesa të komunitetit serb, janë të domosdoshme. Kushdo që vijon ta cenojë këtë të drejtë themelore nuk ka çfarë të presë tjetër përveçse përgjigjen e institucioneve tona me forcën e

ligjit”, tha Kurti. Ai tha se për organizimin e zgjedhjeve është ndarë buxheti i nevojshëm dhe se institucionet e tjera të përfshira në këtë proces janë duke bërë përgatitjet e nevojshme.

Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Ariana Musliu - Shoshi, tha se Komisioni Qendror Zgjedhor i Kosovës është duke u përballur me probleme të shumta në procesin e organizimit të zgjedhjeve. Ajo përmendi bartjen e materialeve zgjedhore, pamundësinë e shfrytëzimit të qendrave të votimit si dhe mungesën e sigurisë si sfidat kryesore me të cilat, siç tha ajo, është duke u përballur stafi i KQZ-së. Kurti pranoi se situata e sigurisë në veri është problematike, porse theksoi se institucionet do ta kryejnë punën e tyre.

parim në rastin e Kosovës është shkelur shumë herë. Është kohë shumë e shkurtër të pranohen kushtëzimet politike të Listës Serbe siç janë formimi i menjëhershëm i Asociacionit - Zajednicës dhe tërheqja e Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës

por... nuk i dihet! Në këto rrethana nuk ka as kushte minimale për mbajtje të zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës. Në anën tjetër, veriu i Kosovës, për shkak të bojkotit, është shndërruar në shkretëtirë të veprimit institucional”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.



KRYETARI I PRISHTINËS, PËRPARIM RAMA, DHE PËRFAQËSUES TË PARTIVE OPOZITARE, JANË SHPREHUR TË SHQETËSUAR PAS INFORMATAVE SE MINISTRIA E FINANCAVE PO BLOKON BARTJEN E TË HYRAVE VETJAKE TË KOMUNAVE NGA VITET PARAPRAKE

Qeveria Kurti po bllokoi bartjen e të hyrave vetjake të komunave

Ministria e Financave po bllokoi bartjen e të hyrave vetjake të komunave nga vitet paraprake ka thënë të enjten kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, teksa i ka bërë thirrje ministrit të Financave, Hekuran Murati, që të mos bllokojë dhe urgjentisht të bëjë bartjen e të hyrave vetjake të Prishtinës. Përndryshe, siç ka thënë ai, do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve të Prishtinës. Ndërkaq partitë opozitare kanë theksuar se nuk do të ketë normalitet në Kuvend nëse tentohet të cenohet pavarësia e komunave

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 6 prill - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se është thellësisht i shqetësuar pas informatave se Ministria e Financave po bllokoi bartjen e të hyrave vetjake të komunave nga vitet paraprake. "Është hera e parë që një qeveri tenton në mënyrë kundërkushtetuese t'i tjetërsojë të hyrat vetjake të komunave. Si kryetar i kryeqytetit u kam kërkuar me

shkrim kryetarit të Kuvendit, kryeministrit dhe ministrit të Financave, që mjetet e mbledhura nga taksat e qytetarëve të kryeqytetit, t'i kthehen Prishtinës ashtu siç i takojnë. Janë 28.8 milionë euro të parapara për 172 projekte kapitale të kryeqytetit për këtë vit të cilat qeveria po ua bllokoi qytetarëve të Prishtinës. Rrugë, shkolla, çerdhe, biblioteka, ujësjellës, parqe e të tjera do të mbesin pa u ndërtuar si pasojë e kësaj bllokade", ka thënë Rama. Ai ka kërkuar nga ministri i

Financave, Hekuran Murati, që të mos bllokojë dhe urgjentisht të bëjë bartjen e të hyrave vetjake të Prishtinës dhe të komunave në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin përkatës për vetëqeverisje lokale. "Nëse këto mjete nuk barten menjëherë, do të konsiderojmë se ky është një veprim i qëllimshëm i qeverisë për ta bllokuar zhvillimin e kryeqytetit. Prandaj, si palë e autorizuar, ne do të detyrohemi t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese në mbrojtje të të

drejtave të qytetarëve të Prishtinës", ka thënë kryetari i Prishtinës, Përparim Rama. Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka reaguar lidhur me bllokimin e të hyrave vetjake të komunave nga vitet paraprake, që është bërë nga Ministria e Financave. Tahiri në seancën e Kuvendit të Kosovës ka marrë fjalën duke thënë se kjo është antikushtetuese dhe e padrejtë. Ai ka kërkuar nga ministri Hekuran Murati dhe kryeministri Albin Kurti që të sqarojnë se mbi çfarë baze po bëhet kjo. Deputeti i AAK-së ka përmendur edhe se si kjo çështje ishte rregulluar me amendamentin e LDK-së kur ishte votuar Ligji për Buxhetin. "Ka të bëjë me një vendim totalisht absurd të ministrit të Financave, Hekuran Muratit. Unë nuk e di a janë të vetëdijshëm që më 15 dhjetor të

vitit 2022 ka kaluar Ligji për Buxhet. Neni 9.6, i cili flet për bilancet e pashpenzuara që kalojnë në Fondin e Kosovës, është ndryshuar me amendamentin e LDK-së, pra u jep të drejtë komunave që t'i përdorë të hyrat vetjake. Unë nuk e di a e di kryeministri, zëvendëskryeministri Besnik Bisimi, që është e padrejtë, është antikushtetuese dhe është ndërhyrje e drejtpërdrejtë në një institucion kushtetues që ofron shërbime në të gjitha komunat e Kosovës ndalja dhe pengesa e shfrytëzimit të të hyrave vetjake. A e kuptoni që s'mund të punoni me këtë arbitraritet? Nuk mundeni me këtë qasje. Mbi çfarë baze i ndalimi të hyrat vetjake? A ka mundësi të na shpjegojnë ministri dhe kryeministri", ka thënë Tahiri. Ndërsa ministri Hekuran Murati ka thënë se kjo çështje

Bislimi: Janë pesë kritere për statutin e Asociacionit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 PRILL -

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka thënë se ka një pajtim të plotë në Bruksel që do të jenë pesë kritere, përmes të cilave do të shihet se a është i pranueshëm si bazë për diskutim drafti i statutit që propozohet nga ekipi menaxhues për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. “E para, a parasheh ky draft një shtresë të re të qeverisjes, e nëse parasheh, nuk konsiderohet i pranueshëm për diskutim të mëtejshëm. E dyta, a parasheh të drejta kolektive, nëse po, e merr epitetin e një drafti të papranueshëm”, ka thënë ai në raportimin para Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Kosovës.

Bislimi përmendi edhe tri kriteret e tjera. “Në ç’masë është [drafti i statutit] në harmoni në marrëveshjet e vitit 2013 dhe 2015 [për Asociacionin]”, vendimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2015 [për Asociacionin] si dhe në ç’masë është në harmoni me letrën që [ish-Përfaqësuesja e Lartë, Federica] Mogherini i ka dërguar qeverisë se çfarë kompetenca mund të ketë Asociacioni”, ka thënë ai.

Zëvendëskryeministri i Kosovës ka thënë se këto “janë pesë siguresa të mjaftueshme që tregojnë se ky mekanizëm apo ky lloj vetëmenaxhimi nuk ka asgjë nga ajo që ne e kemi quajtur Zajednica [Asociacioni]”.

Por, drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, tha se “kjo është një gënjeshtër e pastër e Bislimit” pasi, sipas tij, në Bruksel nuk u përmendën “pesë kriteret për Asociacionin për të cilat ai foli sot”. Ai ka thënë se në takimin e 4 prillit u fol për statutin e Asociacionit dhe Ekipin Menaxhues.

Më 27 shkurt, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër



Takimi i radhës Kurti - Vuçiq, këtë muaj

I pyetur nga gazetarët të enjten se a është gati drafti që do të paraqitet për formimin e Asociacionit, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se fillimisht do t’i analizojë me Bislimin “rezultatet nga takimi që është zhvilluar në Bruksel më 4 prill, mandej do të përcaktojë një ecje përpara për muajin prill brenda të cilit do të ketë edhe një takim të nivelit të lartë”. “Edhe një herë po theksoj se duhet të zbatohet e gjithë marrëveshja dhe në kuadër të marrëveshjes kemi një nen, i dhjetë, që është për zbatimin e marrëveshjeve të mëhershme, por si një çështje urgjente në aneksin e zbatimit që u dakordua në Ohër, parashihet pikërisht çështja e të pagjeturve nga lufta, përkatësisht e të zhdukurve me dhunë”, tha ai pas një ngjarjeje në Prishtinë.

Vuçiq, pranuan marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve në bazë të propozimit evropian, ndërsa më 18 mars në Ohër u pajtuan për Aneksin për zbatimin e saj. Aty parashihet edhe zbatimi i të gjitha marrëveshjeve të arritura deri më tash në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, përfshirë edhe atë për formimin e Asociacionit, të cilin qeveria në Prishtinë e ka refuzuar deri më tash, me arsyetimin se mund ta

rrezikojë funksionalitetin e shtetit.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Po më 2015 Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën. Por, kjo gjykatë ka thënë se ky asociacion mund të formohet nëse parimet që nuk janë në harmonizim me Kushtetutën, harmonizohen.

Operacion policor në Prishtinë e Pejë, arrestohen 10 persona të përfshirë në krim të organizuar

Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar e Policisë së Kosovës ka vënë në pranga dhjetë persona të dyshuar, gjashtë të tjerë mbeten në kërkim policor

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 PRILL - Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, në kuadër të Policisë së Kosovës, me autorizim të prokurorit të shtetit - Prokuroria Speciale e Kosovës dhe në mbështetje të njëjstëve të specializuara policore (NjRSh, njësitë e Krimteknikës) ka zbatuar urdhëresën e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special për arrestimin e personave të dyshuar dhe kontrollin e disa lokacioneve për shkak të dyshimit se personat e dyshuar kanë qenë të përfshirë në veprat penale ‘krim i organizuar’, ‘organizim i skemave

piramidale dhe bixhozit të paligjshëm.

Operacioni policor është realizuar në dy rajone të Republikës së Kosovës, Prishtinë dhe Pejë.

Ky operacion policor është zhvilluar pas hetimeve disamujore, ku personat e dyshuar në bashkëveprim me njëri-tjetrin dyshohet se kanë kryer veprat penale të lartcekura për një periudhë të gjatë kohore. “Gjatë operacionit janë kontrolluar dymbëdhjetë lokacione (vendbanime dhe lokale), janë ndaluar dhjetë persona me aktvendim mbi ndalimin si dhe janë intervistuar edhe pesëmbëdhjetë persona të tjerë në cilësinë e të dyshuarve të cilët lirohen në

procedurë të rregullt. Ata janë hasur duke mundësuar zhvillimin e lojërave të bixhozit online. Gjatë kontrollit edhe gjashtë të dyshuar të tjerë nuk janë hasur në lokacionet e tyre, andaj mbeten në kërkim policor”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Sipas këtij njoftimi, në cilësi të provave materiale janë sekuestruar para të gatshme 4 423.00 euro, aparate të lojërave të fatit dy copë, telefona mobilë 25 copë, kompjuterë laptop dy copë, DVR dy copë si dhe materiale/dokumente relevante për rastin. Me urdhër të prokurorit kompetent dhjetë të dyshuarit e arrestuar dërgohen në mbajtje për 48 orë.



rregullohet me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike i cili parasheh bartjen e të hyrave vetjake nga viti vijues. “Kjo çështje rregullohet me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike i cili parasheh bartjen e të hyrave vetjake nga viti vijues. Ligji për Buxhetin e

parasheh këtë dhe po e zbatojmë këtë”, ka deklaruar ministri Murati.

Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë se nuk do të ketë normalitet në këtë Kuvend nëse tentohet të cenohet pavarësia e komunave. “Ministri i Financave

po tenton ta prekë atë që është e rregulluar me Ligjin e Menaxhimin e Financave Publike. Financat lokale menaxhohen nga Ligji për Menaxhimin e Financave Lokale. Prandaj, mos bëni kësi skena, se po na detyroni të shkojmë në drejtime që janë të

pakthyeshme. Ju garantoj se nuk do të ketë normalitet në këtë Kuvend nëse tentohet të cenohet pavarësia e autoriteteve lokale apo komunave. Nuk do të kesh mundësi t’i marrësh paratë e komunave”, ka theksuar Gashi. Kushtetuta e Kosovës, neni 124, organizimi dhe funksionimi i

vetëqeverisjes lokale, në pikën 5, përcakton: “Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga qeveria qendrore, në pajtim me ligjin”.

Opozita: Puna e qeverisë, arbitrare dhe antikushtetuese

Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të enjten debat parlamentar në lidhje me punën dyvjeçare të qeverisë Kurti. Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka theksuar se në dy vjetët e fundit është veçuar me politikë arbitrare, antikushtetuese dhe varfëruese

PRISHTINË, 6 PRILL - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka thënë se qeverisja e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në dy vjetët e fundit është veçuar me politikë arbitrare, antikushtetuese dhe varfëruese. Ai i ka bërë këto komente teksa ka paraqitur një propozim-rezolutë për punën dyvjeçare të Qeverisë së Kosovës.

Duke kritikuar punën e qeverisë, Tahiri ka thënë se ekzekutivi ka lënë pa udhëheqës dhe borde drejtuese disa prej agjencive më të rëndësishme të shtetit, përfshirë Trustin dhe Bankën Qendrore të Kosovës. "Qeveria është arbitrare në vendimet që i ka marrë, në punësimet që i ka bërë - puro me kriter politik, partiak dhe nepotist", ka theksuar Tahiri.

Tahiri, më tej, ka përmendur një serë aspektesh të tjera, në të cilat, sipas tij, qeveria ka dështuar në zhvillimin e politikave të mirëfillta, përfshirë këtu ekonominë dhe politikën e jashtme.

Kritika për qeverinë pati edhe kryetari i Partisë Demokratike të

Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, i cili tha se për shkak të problemeve me të cilat po përballon Kosova, është rritur numri i qytetarëve që po migrojnë jashtë vendit. "Përgjatë dy vjetëve të fundit mesatarisht 147 persona në ditë e lëshojnë Kosovën për të kërkuar një jetë më të mirë jashtë vendit. Mesatarisht mbi 1 000 qytetarë në javë", ka deklaruar Krasniqi. Ndërkohë, shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, kritikoi qeverinë për nivelin e lartë të importit nga Serbia. "Rezultati është deficit tregtar i paparë më herët", ka thënë Gashi, duke e akuzuar qeverinë për mosmbajtje premtimesh dhe keqmenaxhim në dikastere të ndryshme.

Kurti: Zhvilluam ekonominë dhe forcuar sundimin e ligjit

Duke iu përgjigjur kritikave të opozitës, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se në dy vjetët e kaluara qeveria ka treguar sukses



në zhvillimin ekonomik të vendit përfshirë rritjen e investimeve, hapjen e vendeve të reja të punës, reformën në drejtësi si dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Duke folur për ekonominë, kryeministri Kurti ka thënë se janë rritur eksportet pasi, sipas tij, "këtë vit do të kalohet vlera prej një miliard eurosh". Kjo, sipas kryeministrit, dëshmon gjallërinë e ekonomisë së Kosovës. "Rritja ekonomike ka rezultuar edhe në rritje të punësimit. Për 21 muaj, nga marsi i vitit 2021 deri në dhjetor 2022, është rritur punësimi primar nga 325 mijë e 467 të

punësuar në 362 mijë e 817 të punësuar. Pra, për 21 muaj, 37 mijë e 350 të punësuar më shumë, dhe numri i grave të punësuar është 50.3 për qind i rritjes së gjithëmbarshme", ka theksuar Kurti.

Ai ka thënë se dy vjet është vetëm gjysma e mandatit, dhe se ende iu mbetet punë për të bërë por, siç ka bërë me dije ai, statistikatat tregojnë se ka sukses të pamohueshëm. "Për dy vjet janë dyfishuar investimet e huaja direkte. Buxheti i shtetit është rritur 760 milionë euro për dy vjet, ndërsa ekonomia është rritur 2.1 miliardë euro", ka shtuar Kurti.

Kurti ka folur edhe për iniciativat e tjera të qeverisë, siç është Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme dhe vetingun në drejtësi. Ndër të tjera, Kurti ka thënë se është punuar në forcimin e rendit dhe ligjit, duke veçuar arrestimin e mbi 300 zyrtarëve të dyshuar për vepra të ndryshme penale.

Qeveria "Kurti 2" u votua në Kuvendin e Kosovës më 22 mars 2021.

Në shkurt të atij viti Lëvizja Vetëvendosje, e drejtuar nga Albin Kurti, fitoi zgjedhjet parlamentare. /REL/

Kurti: Strategjia e re e E-Qeverisjes 2023-2027, një vizion për një administratë publike të digjitalizuar

PRISHTINË, 6 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ishte një nga folësit kryesorë në Konferencën për Strategjinë e E-Qeverisjes që ka në funksion përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike, të organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Në adresimin e tij ai tha Strategjia e re e E-Qeverisjes 2023-2027 që po e prezantojmë sot vendos vizionin tonë për një administratë publike të digjitalizuar që ndikon në mirëqenien e qytetarëve, maksimizon efektivitetin, transparencën dhe llogaridhënien e qeverisjes dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike të vendit.

Më tej, tha se Strategjia parasheh reforma përmbytësore, që bazohen në parimet kyçe të Komisionit Evropian për digjitalizim të shërbimeve, e që synojnë, siç tha ai, ta transformojnë mënyrën se si qytetarët ndërveprojnë me administratën publike. "Sipas Indeksit të Maturitetit të Teknologjisë të Bankës Botërore, jemi ngritur nga grupi C në grupin B, për fokusin në qeverisje digjitale dhe platforma eKosova ka mbi 770 mijë përdorues, tashmë i kemi mbi 130 shërbime elektronike", ka theksuar Kurti.

Duke folur për parimet e kësaj strategjie, kryeministri Kurti potencoi faktin se dy nga shtyllat janë sistemet dhe infrastruktura digjitale e vendit. "Strategjia parasheh ndërtimin e arkitekturës gjithëpërfshirëse të organizatave, infrastrukturës, sistemeve, të dhënave dhe ndërveprimit, që do të mundësojë zhvillim të qëndrueshëm të digjitalizimit në qeveri dhe tashmë kemi mbuluar 100 % të zonave të banuara me internet brezgjërë. Si rezultat, Kosova është në top 7 shtetet në Evropë dhe krahasohet me Zvicrën e Luksemburgun", veçoi kryeministri Kurti.

Ai ka theksuar se në Strategji, po ashtu, parashihet edhe pilotimi i qendrave të integruara të shërbimeve, që do ta ofrojnë konceptin e one-stop-shop, për marrjen e shumë shërbimeve në një lokacion të vetëm.

E derisa jemi duke lëvizur drejt një të ardhmeje gjithnjë e më digjitale, kryeministri Kurti, po ashtu, nënvizoi edhe rrezikun nga kërcënimet dhe sulmet kibernetike. Për këtë ai tha se rritja e sigurisë dhe qëndrueshmërisë kibernetike të sistemeve dhe infrastrukturës digjitale qeveritare është një edhe një shtyllë tjetër e rëndësishme e strategjisë. "Natyrisht, pjesa më



sfiduese e çdo strategjie është zbatimi i saj", u shpreh Kurti, andaj edhe u shpreh i lumtur që disa nga partnerët tanë zhvillimorë tashmë kanë treguar

gatishmërinë për ta përkrahur zbatimin e kësaj strategjie dhe të planit të veprimit.

Në fund, kryeministri Kurti ka falënderuar Akademinë Estoneze

për e-Qeverisje (eGA) për bashkëpunim në hartimin e kësaj strategjie dhe GIZ-in për përkrahjen për realizimin e këtij bashkëpunimi.

Prokuroria Speciale shenjëstron një rast të ri me gjashtë persona

PRISHTINË, 6 PRILL - Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj, ka mbajtur të enjten takimin e radhës me ekipin e përbashkët për përzgjedhjen dhe shenjëstrimin e krimeve të rënda, të cilët kanë shenjëstruar një rast të ri të

koduar "Zhuri", në të cilin janë të përfshirë gjashtë persona. Prokuroria Speciale njofton se rasti është shenjëstruar për veprat penale "Shpëlarje e parasë" nga neni 302 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe lidhur me nenin 56 të ligjit nr. 05/L- 096, për Parandalimin

e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit, si dhe "Mashtrimi kompjuterik, i kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal". Po nga ky rast janë sekuestruar para në vlerë prej 1,546,753.93 eurosh.



Poshtërsia tjetër e Gjykatës Speciale ndaj Salih Mustafës



Gjykata Speciale ka nxjerrë të enjten një vendim, me të cilin e detyron ish-komandantin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Salih Mustafa, t'ua paguajë 207 mijë euro viktimave të vrasjes së paligjshme, ndalimit arbitrar dhe torturës. Kryetari i OVL-UÇK-së, Faton Klinaku, ka thënë se kjo është poshtërsia tjetër e Gjykatës Speciale ndaj Salih Mustafës

PRISHTINË, 6 PRILL (ER) - Gjykata Speciale e Kosovës, me seli në Hagë, ka nxjerrë të enjten një vendim, me të cilin e detyron ish-komandantin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Salih Mustafa, t'ua paguajë 207 mijë euro viktimave të vrasjes së paligjshme, ndalimit arbitrar dhe torturës. Më 16 dhjetor 2022 Mustafa u dënua me 26 vjet burgim nga Gjykata Speciale, si i akuzuar për këto vepra që, sipas gjykatës, janë

kryer në vitin 1999, kur në Kosovë po zhvillohej luftë në mes të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave serbe. Sipas aktakuzës, Salih Mustafa, i njohur si 'komandant Cali', ka qenë komandant i njësitit gueril BIA, njësit brenda Zonës Operative të Llapit (ZOLL) të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në shpalljen e urdhrin për zhdëmtim më 6 prill 2023, gjykata konstatoi tetë viktimat, të cilave do t'u takojë dëmshpërblimi.

Tri prej tyre konsiderohen viktimat të drejtpërdrejta. Përkatësisht, sipas vendimit të gjykatës, ata kishin qenë të ndaluar në një qendër ndalimi në Zllash dhe kishin pësuar dëmtime fizike dhe mendore nga keqtrajtimi. Sipas gjykatës, atyre u është shkaktuar edhe dëm material pasi ai keqtrajtim ua kishte ndryshuar rrjedhën e jetës dhe pamundësuar zhvillimin e një karriere. Për këto viktimat, me urdhër të gjykatës, u përcaktua dëmshpërblimi prej 80 mijë, 60 mijë dhe përkatësisht 30 mijë eurosh. Tutje, në urdhër u përfshinë edhe pesë viktimat jo të drejtpërdrejta që janë familjarë të një personi të vdekur në prill të vitit 1999 dhe që vdekja e tij, sipas gjykatës, "mund t'u atribuohet veprimeve dhe mosveprimeve të zotit Mustafa si

komandant i BIA-s". Këta familjarë u dëmshpërblyen veç e veç: Tre prej tyre me nga 10 mijë euro, një me pesë mijë dhe një me dy mijë euro. Sipas vendimit të gjykatës, përgjegjësinë e pagesës së këtyre dëmeve e ka ekskluzivisht Salih Mustafa. Aktualisht, sipas gjykatës, është konstatuar se Mustafa nuk i zotëron mjetet për ta bërë këtë pagesë dhe kështu pritet përcaktimi i një autoriteti mbikëqyrës në lidhje me zbatimin e urdhrin për dëmshpërblim, i cili do t'i përcaktojë edhe më hollësisht mundësitë financiare të Mustafës për ta paguar dëmshpërblimin. Më tutje, buxheti i shtetit të Kosovës përmes Ministrisë së Drejtësisë është përmendur si opsion për ta siguruar pagesën e viktimave. Kryetari i Organizatës së

Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK), Faton Klinaku, ka reaguar pas vendimit të Gjykatës Speciale për 207 mijë euro dëmshpërblim për viktimat në çështjen gjyqësore kundër Salih Mustafës. Klinaku përmes një postimi në rrjetin social në "Facebook" e ka quajtur këtë vendim "poshtërsi e Gjykatës Speciale". Sipas tij, këto para duhet t'i paguajë gjykata, siç u shpreh ai, sepse po i konsideron viktimat. "Poshtërsia tjetër në Gjykatën Speciale: Përveç që e kanë dënuar padrejtësisht e politikisht me 26 vjet burgim, marrin vendim kundër Calit që t'i paguajë 'viktimat' me 207 000 euro. Me siguri që kështu nuk ka qenë as në kohën e Jugosllavisë. P.S. Le t'i paguajë gjykata ata që i konsideron viktimat, sepse para po ka për vete", ka shkruar Klinaku.

Drejtoresha e ShSKUK-së viziton Klinikën e Neonatologjisë, informohet me punën në këtë klinikë

PRISHTINË, 6 PRILL - Drejtoresha e përgjithshme e Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, dr. Narqize Arënlju-Hoxha, me drejtor dhe stafin e klinikave të QKUK-së, kanë

vizituar Klinikën e Neonatologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Ata janë pritur nga drejtoresha e kësaj klinike, dr. Hajrije Ismaili si dhe stafi shëndetësor.

Qëllimi i kësaj vizite ishte të informohen rreth punës, sfidave dhe nevojave të kësaj klinike si dhe për ta vlerësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara nga kjo klinikë.



Pa doreza e pa çizme në minierën e “Trepçës”



PRISHTINË, 6 PRILL - “Gjysma e punëtorëve i kanë të thyera helmetat...”. “Çizmet i blejmë vetë...”. “As doreza, as rroba nuk kemi marrë”... Kjo është gjendja e disa punëtorëve në Kombinatin Metalurgjik “Trepça”, sipas Agim Rullanit, mbikëqyrës i minatorëve në horizontin e 10 të kësaj miniere. Mungesat, sipas tij, janë bërë më të theksuara në tre muajt e fundit, por ai nuk flet për arsyet. Nga ndërmarrja, që dikur ka qenë motor i ekonomisë së Kosovës dhe më gjerë, punëtorët marrin vetëm disa mjete. “Llambën ndriçuese dhe helmetën”, thotë Liridon Hajdari, i cili që 12 vjet punon në minierë.

“Helmeta është më e fortë dhe blihet më rrallë. Të tjerat... me çizme, me rroba, me doreza i sigurojmë vetë. Ne nuk duhet t'i blejmë, por nuk ka. Dhe, më mirë t'i blesh vetë sesa të punosh pa to”, thotë ai për “Radion Evropa e Lirë”.

Pajisjet personale nuk janë problem i vetëm për minatorët, që shpesh iu duhet të futen deri në 800 metra nën sipërfaqen e tokës.

Edhe mjetet e punës janë shumë të vjetruara, thotë kryetari i Sindikatës së Minatorëve, Ibrahim Jonuzi. “Shkaku i mungesës së investimeve kapitale dhe investimeve në mjetet e punës, minatorët gjenden në situatë të vështirë dhe kushtet e punës janë jashtëzakonisht të rënda”,

thotë ai për “Radion Evropa e Lirë”.

Udhëheqësia e kombinatit nuk iu përgjigj pyetjeve të “Radios Evropa e Lirë” në lidhje me mungesat e pajisjeve personale dhe të mjeteve për minatorë. Kombinati Metalurgjik “Trepça” gjendet në Mitrovicë, me sektorë që shtrihen në pjesën veriore dhe atë jugore të qytetit. Ai numëron rreth 1 300 punëtorë. Produkte kryesore të minierave të tij janë: koncentratet e plumbit dhe zinkut me përmbajtje të argjendit, arit dhe mineraleve të tjera.

“Pështymë zi”

Hajdari, i cili punon si xehetar në horizontin e 11-të të minierës, nuk është i kënaqur as me pagën që merr. Ai paguhet rreth 750 euro në muaj dhe thotë se kjo shumë është e padinjitetshme në raport me vështirësitë që i ka puna. “Në hapësirën ku punoj, ajri është shumë i rëndë, ka shumë gazra, që formohen nga tymi, pluhuri dhe lagështia. Ne, kur e përfundojmë punën dhe dalim mbi sipërfaqe, pështymë zi. Unë nuk pi cigare, merrem edhe me sport, por prapë ngjyra e lëngut të pështymës është e zezë”, thotë 33-vjeçari. Jonuzi, nga Sindikata e Minatorëve, thotë se gjendjen e punonjësve në këtë aspekt e vështirëson edhe inflacioni i lartë, që ka goditur Kosovën për

më shumë se një vit. “Më herët paga ka qenë më e mirë, por duke marrë parasysh rritjen e inflacionit dhe të çmimeve, paga e minatorëve është e pamjaftueshme”, thotë ai.

Për më tepër, shton Jonuzi, minatorët preken shpesh edhe nga sëmundje që u shkakton profesioni dhe ata nuk kanë as sigurim shëndetësor, as jetësor. Këtë javë Policia e Kosovës ka konfirmuar vdekjen e një punëtorë në ambientet e kombinatit “Trepça”. Hetuesit policorë, me autorizim të prokurorit, janë duke bërë hetime për identifikimin dhe zbardhjen e rrethanave të rastit, por ende nuk ka ndonjë informacion në lidhje me të.

Kohë pas kohe ka edhe incidente të natyrës teknike. Në fund të shtatorit të kaluar, për shkak të një defekti me energji elektrike në minierën e Stantërgut - pjesë e “Trepçës” - mbi 120 punëtorë kanë mbetur të ngujuar për një kohë në thellësi mbi 800 metra nën tokë.

Edhe “pension diskriminues”

Por, sipas Jonuzit, diskriminimi më i madh që u bëhet minatorëve ndodh pas daljes në pension. Shumica prej tyre marrin pension prej 100 eurosh në muaj, pasi nuk e kanë të regjistruar gjithë përvojën e kërkuar të punës - sidomos gjatë viteve '90, kur Kosova ishte

nën masa të dhunshme të regjimit të atëhershëm të Serbisë.

Përvoja e punës dhe kualifikimi arsimor janë kritere kryesore për kategorizimin e shkallës së pensionistëve në Kosovë.

Sipas Ligjit për Skemat Pensionale, të drejtën në pension kontribut-pagues në Kosovë e kanë personat që kanë arritur moshën 65-vjeçare dhe kanë së paku 15 vjet stazh pune para vitit 1999.

Jonuzi thotë se shumica e minatorëve, para luftës së viteve 1998/99, kanë pasur përvojë pune deri në nëntë vjet. Dhe kjo është arsyeja që minatorët përfundojnë me pension të pleqërisë, që është rreth 100 euro në muaj. Pavarësisht se punon nga viti 1981, Agim Rullani, 60 vjeç, do të dalë në pension edhe pesë vjet me vetëm 100 euro në muaj. “Unë nuk i kam 15 vjet përvojë pune para luftës. Kam filluar punën në vitin 1981, por në vitin 1990 masat e dhunshme të Serbisë na larguan nga puna. Këta nëntë vjet të largimit nuk na njihen si stazh. Kështu që kam vetëm nëntë vjet përvojë, që nuk ma mundësojnë pensionin kontributpagues. Me 100 euro dal në pension”, thotë Rullani.

Një historik i shkurtër i “Trepçës”

Kompleksi Metalurgjik “Trepça” deri në vitet '90 kur

është përkeqësuar situata politike është llogaritur si një prej ndërmarrjeve më të mëdha jo vetëm në Kosovë, por edhe në territorin e Jugosllavisë së atëhershme. Me rreth 20 000 punëtorë, ai është cilësuar si shtylla kryesore e ekonomisë së Kosovës dhe ish-Jugosllavisë. Sipas të dhënave të institucioneve të Kosovës, nga viti 1945 deri në periudhën para vitit 1990 nga minierat e “Trepçës” janë nxjerrë rreth 600 mijë tonë xehe në vit.

Rënia e prodhimit ka nisur në vitet '90 kur regjimi i atëhershëm i Serbisë ka vendosur masa të dhunshme në Kosovë, duke mbyllur gati të gjitha ndërmarrjet dhe institucionet në vend. Por, “Trepçën” e kanë përcjellë probleme edhe pas përfundimit të luftës në Kosovë më 1999. Ndërmarrja nuk ka arritur asnjëherë të vihet në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

Makineritë e vjetruara mbi 50 vjet dhe mungesa e mirëmbajtjes janë shndërruar në probleme të vazhdueshme. “Trepça” pritet të kalojë nën Fondin Sovran të Qeverisë së Kosovës. Ky fond pritet t'i marrë nën pronësi të gjitha asetet strategjike të Kosovës për të investuar më pas në rritjen e vlerës së tyre.

Ligji për Fondin Sovran pritet të miratohet brenda këtij viti.

Shtyhet sërish afati për aplikim për subvencione në bujqësi

Prishtinë, 6 prill - Ministria e Bujqësisë ka njoftuar fermerët se ka shtyrë sërish afatin për aplikim në Programin për Pagesa

Direkte/Subvencione. Përmes një njoftimi në faqen zyrtare, MBPZHR-ja ka bërë me dije se afati është zgjatur për shtatë ditë.

“Shtyhet për herë të dytë e të fundit afati për aplikim në Programin për Pagesa Direkte/Subvencione 2023.

Zgjatja e këtij afati bëhet përshtatë ditë, përkatësisht nga data 7 prill 2023 deri më 14 prill 2023 në orën 16:00”, thuhet në njoftim.



AJAZ EMINI - Ditar (X)

NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT

Ishte rreth orës 1:00 pas mesnate, dhe si zakonisht edhe sonte shkuam me dy makina Hamvee. Prej Gjilanit vazhduam rrugën në drejtim të Prishtinës. Pas dhjetëra kilometrash dolëm në të majtë të rrugës nga rruga kryesore, dhe aty në afërsi të një lumi të vogël u ndalëm dhe parkuam.

I fikëm makinat me qëllim që mos të ndëgjohej asgjë, sepse nuk ishim shumë largë nga vendet që ankoheshin. Posa u ndalëm filloi një rrebesh shiu i tmerrshëm, për çka kapiteni më tha që unë të qëndroja në makinë, e ai me kolegët e tij të dalin në malin përsipër që nuk ishte aq largë fshatrave, dhe të vëzhgojnë për një kohë për ndonjë gjuajtje armësh.

-Pas dy orësh në bjeshkët e përsipër rrugës të vëzhgimit që të gjithë u kthyen, të rraskapitur nga era e fortë dhe rrebeshi i shiut. Nuk kishin ndëgjuar asgjë, e që sipas të gjitha gjasave dukej se që të dy palët vetëmse po na gënjenin neve. Njëri nga kolegët i quajtur "Baba" e filloi tregimin e vetë se çka i kishte ndodhur atje lartë në pyellin e dendur. Ai rrëfente se gjatë vëzhgimit derisa kishin qëndruar mbrenda pyllit të dendur, kishte ndëgjuar një zë që gjithënjë e më tepër po i afrohej atij. Mirëpo kishte kërkuar gjithëandej dhe nuk kishte parë askënd! E kishte provuar për të parë me dylbitë e territ night vision, edhe me dylbitë thermo që tregojnë trupat e gjallë edhe prapa liseve apo edhe prapa murit, dhe nuk kishte parë asgjë. Zhurma e ecjes nëpër gjeteth e thata të drunjëve që ishin për tokë gjithënjë e më tepër po i afrohej, por me ndërprerje të vogla të sajë e që gati sa e kishin çmendur ushtarin e shkretë. Siç duket "Baba" ishte frikësuar pa masë, sepse nuk kishte pasë mundësi që të shohë apo hetojë se kush apo çka ishte, e që po i afrohej gjithënjë e më afër tij! Kur iu kishte afruar krejtë afër këmbëve të tij, atëherë e kishte vërejtë se ajo kishte qenë vetëmse një breshkë e thjeshtë mali! Në mbarim të rrëfimit të tij, që të gjithë filluam së qeshuri me të madhe, se sa shumë ishte trishtuar "Baba" i shkretë, në thellësi të atij pyellit të dendur. Mua personalisht më dukej si një tregim shumë interesant i një pjese të jetës ushtarake, për çka deshta që ta ndajë edhe me ju lexues të dashur...

Në fund të Gushtit 1999 para se të fillojë viti i ri shkollorë, grupi ynë i Njësisë Speciale të Armatës Amerikane u tërhoqem nga objekti i shkollës "Selami Hallaçi" në Gjilan, dhe u transferuam me një shtëpi private të marrë me qira në qytetin e Ferizajit. Në Ferizaj ishim dy grupe të Njësisë të Forcave Speciale të Armatës Amerikane, në të dy anët dhe në afërsi të autostradës Shkup-Prishtinë. Unë isha me



grupin në anën e majtë të rrugës e kurëse në anën e djathtë ishte Shabani, me të cilin ishim nisur së bashku prej SHBA's për në Shqipëri, atje ku unë po punoja me grupin e speciale në Kukës e ai në Bajram Curr.

Në Ferizaj për derisa qëndrova me njësinë e njejtë, vazhduam të njejtën detyrë.

Në Ferizaj patëm rastin të njihemi edhe shoqërohemi edhe me disa ish pjesëtarë të UÇK-s, si:

Skender Bega, Miftar Bega (ish kampion Ballkanik në "Bodybiller") dhe Avni Parllakun të cilët më vonë do të na ndihmojnë me zbardhjen e disa vendeve që supozohej se ishin varreza masive diku në mal në Nerodime të Ferizajit, andej ku ishin zhvilluar edhe shumë beteja në mes të UÇK's dhe forcave të armikut serb.

Pas çlirimit të Kosovës filluan të mbahen shumë manifestime, dhe në njërin prej tyre që po mbahej gjatë Nëntorit të vitit 1999 të organizuar në Klubin "ABC" të Prishtinës, na ftuan edhe neve shokët nga Ferizaji: Miftar Bega me Avni Parllaku të cilën ftesë e pranua me shumë dëshirë. Në mbrëmjen e ahengut nga Ferizaji u nisëm me dy makina, në njërin unë me dy pjesëtarë të Forcave Speciale të Armatës Amerikane me veshje civile, por edhe makinën tonë SUV civile që Armata e SHBA's tani na i kishte dhënë në shfrytëzim, kurse në makinën tjetër të tyre ishin Miftari me Avniun.

Në manifestimin e organizuar po merrnin pjesë shumë yje të estradës së muzikës popullore Shqipëtare si: Ilir Shaqiri, Nusret Muçiqi, Afrim Muçiqi, Dani, etj. Ambienti, muzika, ushqimi dhe shoqëria ishin në nivel të shkëlqyer, përveçse njërit të pranishmëve, ndoshta e kishte edhe nga alkooli apo edhe xhelozia e një femre nga Ferizaji që po na shoqëronte, filloi që të na bezdisë dhe kohë pas kohe gjatë vallëzimit po e shtynte njërin nga kolegët e mijë ushtarak, i cili na tregoi dhe me

shumë mjeshtri po i largohej ngatërresës. Pas përfundimit të programit muzikorë, derisa ne po largoheshim në drejtim të makinës që kishim, ai maskarai që donte të ngatërrohej me ushtarin. Por tani kishte edhe njërin nga shokët e tij, që të dy ishin shtat ligësht, por karagozë që po na ndjeknin pas. Kur u afruan afër makinës tonë për njëherë njëri prej tyre deshti që ta grushtojë kolegun tonë pa kurrëfarë arsye!

Sa për njoftim, pjesëtarët e Forcave Speciale në Armatën Amerikane janë elita ushtarake Amerikane, që donë të thotë se ata janë më të aftit e të aftëve, sepse ata janë në ushtrime të përditëshme fizike e poashtu edhe psikikisht mjaftë të përgaditur! Për të qenë pjesë e Forcave Speciale këta ushtarë kanë kurse specifike dhe tepër të vështira për t'i kaluar për derisa të pranohen që të jenë pjesëtarë të kësaj elite!

Derisa ngriti grushtin lartë shqiptari i shkretë shtat ligësht që t'i bjerë kolegut tonë ushtarak, atë veçse e pamë të shtrirë në asfalt nga grushti që e mori prej ushtarakut. Aksionin e tij e vazhdoi shoku tjetër i tij, por në të njejtën mënyrë si i pari edhe ky derisa po ia mësyente ta grushtojë ushtarakun, edhe ky u pa më keq i shtrirë në asfalt. Po, vetëmse nga një e mëshuar nga grushti i rëndë i ushtarit dhe tepër të fuqishëm që i ra si prej qiellit, edhe pësoi edhe më keq se i pari, të cilit pas ramjes vetëmse iu rrotulluan edhe sytë e s'po dinte asgjë.

Meqenëse ishte fundi i mbrëmjes shumica kishin dalë jashtë në parking dhe në ndërkohë shumë prej tyre vrapuan drejtë nesh për të na ndërhyrë, që të na ndajnë nga ky sherr i pa pritur, e në mesin e të cilëve ishte edhe vetë këngëtarin Nusret Muçiqi. Meqenëse edhe kolegë të mijë ushtarakë e kishin tepruar me alkohol, unë me të shpejtë ia mora çelësat e makinës ushtarit që na kishte vozitë për në aheng

edhe i tërhoqa pas vete që të dy. Hymë në makinë edhe unë me shpejtësi që mos të na ndodhë edhe ndonjë gjë edhe më e keqe sepse kolegët e mijë ishin nxehë pakë nga alkoholi, por edhe nga ngatërresa, edhe ishin të armatosur me revolet e tyre ushtarake, me të shpejtë u larguam në drejtim të Ferizajit nga ky vend i sherrit. Gjatë rrugës u përbetaam që në lidhje me këtë incident mos ta dijë askush, as kapiteni e as kolegët tjerë, sepse përdryshe dihej se ç'do t'i ndodhte karrierës së tyre ushtarake! Jo vetëm që do t'i largonin nga njësi të tyre, por ndoshta edhe do t'i denonin me burg ushtarak...

Me të gjitha rregulloret ushtarake ne e kishim të ndaluar rreptësisht konsumin e alkoolit, e mos të flasim për shkuarjen në ahengje private...

KALIMI IM NË NJËSINË E JURISPODENCËS SË ARMATËS AMERIKANE (JAG / JUDGE ADVOCATE GENERALS CORP) NGA NJËSIA E FORCAVE SPECIALE TË ARMATËS AMERIKANE

Pas një viti të punës time me Njësinë e Forcave Speciale të Armatës Amerikane filluan shumë gjëra të ndryshojnë, sidomos pas ardhjes së personelit të rijë. Nga ana tjetër tani në bazën ushtarake të Bondsteel'it e kisha edhe bashkëshorten Shahadijen, si dhe kishim sjellë edhe fëmijët te familja e vëllaut Murtezanit në fshatin Llojan. Mu për këtë arsye vendosa që të bëjë lëvizje nga Njësia e Forcave Speciale në Njësinë e Jurispodencës "JAG" (The Judge Advocate Generals Corp), e cila mirret me të gjitha lëndët e drejtësisë ushtarake dhe civile, si dhe mbrojtjen dhe këshillëdhënien juridike, si dhe ku po punonte edhe

bashkëshortja ime Shahadija. Kalimi im në JAG u prit shumë mirë dhe me shumë entuziazëm nga i gjithë personeli i grupit ushtarak që udhëhoqej nga Kapiteni Kovach, dhe ai civil i shqiptarëve që kryesohej nga Gjykatësi Selman Bogiqi dhe Prokurori Miftar Jasiqi nga Gjykata e Prishtinës.

Në këtë detyrë të re e kisha edhe një përparësi të madhe, sepse shumë më herët në Universitetin e Prishtinës kisha studjuar Gazetari/Drejtesi, dhe deri diku e kisha të njohur edhe terminologjinë e fjalëve të ndryshme juridike që përdorehin.

Shahadija që nga ardhja e sajë në Bondsteel kishte qenë e caktuar që të punojë me këtë grup juristësh, gjë e cila më lehtësoi shumë edhe adoptimin tim në këtë detyrë të re.

Puna kryesore e këtij grupi juristësh ushtarak, ishte punët juridike për ushtarakët e Bondsteel'it si dhe kontrolli edhe vurma e themeleve të drejtësisë në Kosovë.

Në zyrën tonë të drejtësisë, apo si me thënë në çadrën tonë të gjykatës së drejtësisë (sepse gjatë kësaj kohe ende gjithëçka ishte në çadra ushtarake), ku po punonim nga e Hëna e deri të Premten, e ku kishim edhe bashkëpunëtorët tanë të grupit të juristëve kosovarë i cili udhëhoqej nga: Selman Bogiqi- Gjykatës dhe Miftar Jasiqi -Prokurorë nga Prishtina si dhe Ymer Huruglica -i Gjykatës së Gjilanit dhe grupeve të juristëve të tjerë të Gjykatës së Ferizajit dhe Gjykatës së Gjilanit.

Në fillim, afër çadrës tonë të gjykatës kishim edhe 3 çadra më të mëdha, të cilat ishin të rrethuara në tela me gjemba dhe me roje ushtarake. Njëra prej tyre shfrytëzohej nga policia ushtarake, aty ku kishin zyrën e tyre, kurse dy të tjerat po shfrytëzoheshin për burgje të mbajtjes së popullatës lokale. Në njërin çadër ishin të vendosur të burgosurit shqiptarë e kurse në tjetrën ishin vendosur të burgosurit serbë, dhe që të gjithë akuzoheshin për veprat e ndryshme penale.

Në fillim të gjitha gjykimet kryheshin nën mbikqyrjen tonë këtu në Kampin Amerikan "Bondsteel" në këtë çadër të thjeshtë të gjykatës, e më vonë me kalimin e kohës filluam edhe funksionimin e Gjykatës së Gjilanit dhe Gjykatës së Ferizajit. Më 23 nëntor 1999, gjatë festës amerikane të faleminderimeve, na erdhën për vizitë në Kampin Ushtarak Amerikan "Bondsteel" të Sojevës: Presidenti i SHBA-së Bill Clinton me të bijën Chelsea, Sekretarësja e Shtetit Amerikan Madeleine Albright, Gjenerali i NATO-së Wesley Clark, i cili udhëhoqi Operacionin e Forcave Aleatea të (bombardimet e NATO's mbi Serbinë dhe forcat serbe) pjesë e së cilës isha edhe unë, Shefi i Kabinetit John Podesta, Këshilltari i Mbrojtjes

Kombëtare Sandy Berger, si dhe 4 pjesëtarët e Kongresit Amerikan: Përfaqësuesi Jack Kingston i Georgia's, Përfaqësuesi Peter Dutsch i Floridës, Përfaqësuesja Carolyn Maloney e qytetit të Nju Jorkut si dhe Përfaqësuesi dhe mikun më i madhë i shqiptarëve Eliot Engel. Mundë të themi lirisht se këtu në Kosovën e lirë sot na erdhi gati se i gjithë kabineti i SHBA-së

Këtu në Kampin "Bondsteel" të Kosovës për të parën herë ne patëm rastin që të takonim dhe të përshëndeteshim me Presidentin Clinton me Sekretarëshën e SHBA's Albright, si dhe Gjeneralin e NATO-së, Clark, me të cilët shkëmbyem edhe një bisedë të shkurtër, e cila ishte më tepër në shenjë faleminderimi për operacionin që kishin ndërmarrë në çlirimin e Kosovës! Gjithashtu edhe ata u interesuan për jetën tonë këtu në kampin ushtarak, dhe më vonë shkrepëm edhe disa fotografi kujtimi, e që do të jenë si fotografi historike sepse në foto kishim çlirimtarët e shtetit më të ri në Kosovës.

Në fund, derisa po bënim një foto së bashku me Gjeneralin më të dashur të shqiptarëve Komandantin Suprem të NATO-së Gjeneralin Wesley Clark, e që do ta shkrepë për ne Shahadija, pasi se ne u bëmë gati dhe pozuam me gjeneralin, Shahadija e shkrepim aparatit por më e keqja ishte se filmi i aparatit na ishte harxhuar. Për çka edhe gjenerali me një buzëqeshje na tha: "Kjo që na ndodhi është e zakonshme, kur fillon të pozojsh shpeshherë të harxhohet filmi ose të prishet fotoaparati, por sigurisht se do të shihemi herave tjera!"

Gjatë kësaj vizite presidenti Clinton mbajti edhe një fjalim para personelit ushtarak të cilin e filloi me fjalët: "Ju faleminderit dhe përshëndetje". Pasi na faleminderoi të gjithëve për punën që po bënim këtu në Kampet Ushtarake Amerikane në "Bondsteel" dhe "Monteith", ai vazhdoi: "Ju faleminderit, ne e rikthyem në normale çdo gjë që shkaktoi pastrimi etnik. Ne kemi misionin e suksesëshëm ushtarak i cili në mënyrë brilante u ekzekutua edhe atë pa asnjë viktimitë ushtarake, dhe tani ne kemi shancë, jo garancion por shancë, që të bashkëpunojmë me këta njerëz dhe të ndërtojmë paqe të qëndrueshme në Ballkan. Tani Operacioni i Forcave Aleate u krye, tani është një detyrë tjetër, po Kampi "Bondsteel" është në vijën e parë të frontit, Operacioni i Përbashkët Kujdestarë (Operation Joint Guardian) do të mbrojtë dhe thellësojë paqen dhe ne po punojmë që ta bëjmë të përjetshëm. Ju në të vërtetë nuk humbët aspak kohë, dhe tregimi i Bondsteel'it lexohet si diçka e levizjeve të Perëndimit të vjetër. Jo shumë kohë më herët këtu ishte livadhe, dhe menjëherë pas ardhjes së NATO's në Kosovë, kjo u bë një koshere aktivitetesh, nëpërmjet të inxhinierisë së Armatës dhe Marinës Detare..."

E martë 2 maj 2000

Ishte ditë me diell dhe ditë e ngrohët pranverore, me punë nuk ishim të nxanun, por sa për të

kaluar kohën po lexoja një libër. Papritmas erdhi cimeri im Mentor Hajdari, atdhetar dhe aktivist i madh nga Nju Jersey i SHBA-së, i moshës mesatare, dhe njeri i fjalës me prejardhje nga Struga. Mentori ishte përkthyes i caktuar që të punonte me Gjeneralët amerikanë në Kampin e Bondsteel'it dhe tani ai po kthehej nga puna. Posa hyri mbrenda më pyeti se a mundem më vonë që të shkojmë së bashku edhe ta shoqëronim Komandantin Suprem të Aleancës së NATO-së për Evropë Gjeneralin Wesley K. Clark, i cili kishte ardhë në vizitën e tij të fundit lamtumirëse në Kampin Bondsteel, dhe më vonë po planifikonte të vizitojë edhe vendet për rreth, si Kllokotin, Vitinë dhe Gjilanin. Menjëherë e pranova kërkesën e kolegut tim, me të cilin kishim marrëdhënie shumë të mira shoqërore. Rreth orës 14:00 pas dite, nga dhoma jonë u nisëm unë me Mentorin dhe shkuam para zyrës së Gjeneralit, dhe atje takuam edhe iu bashkangjitëm eskortës ushtarake.

Kjo ishte hera e dytë që po e takoja Gjeneralin Wesley Clark në Kosovë, këtu në kampin e ushtrisë amerikane, në Bondsteel. Pas disa minutash doli edhe Gjenerali Clark, i cili me një buzëqeshje na u afrua dhe u njoftua me të gjithë grupin që do ta shoqëronim, dhe pas disa çastesh u nisëm në drejtim të Kllokotit.

Në Kllokot arritëm pas disa minutash, së pari u ndalëm në fabrikën e ujit mineral Kllokoti. Në fabrikë u njoftuam me grupin e punëtorëve që ende ishin shumicë serbe, si duket kishin mbetur nga koha e Millosheviqit të cilët edhe me ne nuk u treguan aq entuziast për ne kur na panë se ne ishim pjesëtarë të Armatës Amerikane, dhe pas disa minutash vazhduam rrugën për në Viti.

Rrugëve të Vititë takuam shumë njerëz, por kuptohet të nacionalitetit shqiptarë edhe secalin qytetarë që po takonim ishin shumë entuziastë të bisedonin si dhe mjaftë të kënaqur për vizitën që po i bënte atyre Gjeneralit Clark. Por, edhe Gjenerali Clark ndjehej mjaftë i kënaqur nga mikëpritja e tyre që po i bëhej.

Nga Vitia u larguam në drejtim të Gjilanit diku rreth orës 15:30 pas dite. Në të hyrë në qytetin e Gjilanit, morëm rrugën alternative e cila ndahej nga rruga kryesore dhe shkoi majtas dhe pershkon për rreth dhe jashta qytetit.

Pas disa kilometrash arritëm në arterjen tjetër të rrugës e cila të çonte për në fshatin Ponesh, dhe aty ku ndahen rrugët Gjenerali Clark shprehi dëshirën që të ndalemi pakë për të parë qytetin nga ajo pikë. U ndalëm e gjithë eskorta dhe që të gjithë dolëm nga makinat, poashtu edhe Gjenerali Clark doli nga makina dhe po shiqonte rreth e rrotull qytetin e Gjilanit nga kjo pikë e që po shtrihej para nesh dhe ndërkohë po bisedonim.

Gjatë kohës së kësaj pauze që po bënim aty, të njejtës rrugë po shihej prej së largu se drejtë nesh po na vinte dhe po na afrohej një



plak, i cili ishte i dobët por shtat gjatë dhe me plis të bardhë mbi kokë, e që po i grahte një bicikletë të vjetër prodhim i ish Jugosllavisë. Derisa ne po bisedonim me gjeneralin në lidhje me historikun e qytetit të Gjilanit, plaku që po i grahte bicikletën kur na u afrua rreth 4-5 m. erdhi, ndali bicikletën në vend dhe derisa kishte një këmbë në tokë e tjetrën në bicikletë, pa e dijtë se kush ishte me ne na u drejtua me duar lartë nga qielli edhe me za të lartë na tha: "Zoti para dhe Amerika pas". Përnjëherë vazhdoi tempon e tij mbi bicikletë, edhe u largua rrugës te poshtë drejt qytetit! Gjenerali Clark disi i habitur nga gjesti i plakut mu drejtua mua sepse gjatë këtij momenti unë qëllova më afër tij, edhe më pyeti se: "Çka na tha plaku me plisin e bardhë?" Menjëherë ia përktheva fjalët e plakut, "Plaku na tha: Zoti para dhe Amerika Pas", fjalët e të cilit disi e shokuan Gjeneralin.

Gjenerali Clark u ndal për një moment dhe po mendonte diçka dhe po e përcillte me shumë vëmendje largimin e plakut, dhe luhati kokën, e iu mbushën sytë me lot. Pastaj na u ktheve neve që ishim për rreth tij edhe na tha: "Ndjehemi mëse të kënaqur për shpëtimin e të gjithë këtyre jetërave të njerëzve të pafajshëm."

Pas kësaj ndalesë përsëri e gjithë eskorta ushtarake vazhduam rrugën e mëtejme në drejtim të qendrës së qytetit. Para aritjes në qendrën e qytetit stopuam edhe në afërsi të kishës ortodokse serbe, aty takuam një plakë të veshur në të zeza të kombësisë serbe. Gjenerali Clark shprehi dëshirën që ta pyes atë se si po kalojnë mirëpo ajo nuk pranoi që të flasë me ne, e cila përnjëherë u largua duke na e dhënë një shikim irritues!

Me Gjeneralin dhe eskortën që kishim, ngadalë kaluam qendrën e qytetit të Gjilanit, aty ku u ndalëm dhe dolëm nga makinat për ca minuta dhe hecëm në këmbë qendrës së qytetit dhe me vonë përsëri i hypëm makinave dhe u larguam për në Kampin e Ushtrisë Amerikane në Bondsteel.

Pas kthimit në kampin ushtarak

Bondsteel, Gjenerali Wesley Clark na u faleminderua që të gjithëve që ishim me të për shërbimin në forcat amerikane, si dhe për shoqërimin e tij gjatë ditës së sotme. Pastaj bëmë edhe përshëndetjen e fundit lamtumirëse me gjeneralin i cili tani po largohej nga detyra e tij në Armatën Amerikane për në pension.

Gjatë kohës së bombardimeve 78 ditore mbi forcat serbe, Gjenerali Wesley K. Clark ishte Komandant Suprem i NATO's për Evropë, si dhe udhëhoqi kampanjën e "Operacionit të Forcave Aleate" në bombardimet mbi forcat serbe në Kosovë si dhe pikat më strategjike mbrenda Serbisë në çlirimin e Kosovës, pjesë e së cilës pata fatin që të jemë dhe unë, gati se që nga fillimi i këtij operacioni, nga i cili edhe ne bartim Medaljen "KOSOVO CAMPAIGN / IN DEFENSE OF HUMANITY" (Fushata e Kosovës / Në Mbrojtje të Njerëzimit) dhe medaljen tjetër "NATO / IN SERVICE OF PEACE AND FREEDOM" (Nato / Në Shërbim të Paqes dhe Lirisë)...

Ky ishte edhe moment i fundit që po takonim Gjeneralin Clark në uniformën ushtarake, sepse kjo ishte edhe vizita e tij e fundit që po i bënte Kosovës dhe bazës ushtarake Amerikane të Bondsteel'it para ikjes së tij në pension nga Armatë e SHBA's.

JAG / NJËSIA E JURISPODENCËS SË PËRGJITHËSHME E ARMATËS AMERIKANE (JUDGE ADVOCATE GENERAL'S CORPS)

Puna jonë në JAG të Armatës Amerikane ishte edhe një lloj privilegji, sepse me këtë njësi të Juristëve të Armatës Amerikane po venim edhe themelet e drejtësisë në Kosovë, drejtësi e cila më vonë do të drejtohej krejtësisht nga juristët kosovarë! Gjatë gjithë këtyre viteve drejtësia kosovare ishte praktikuar nga një shumicë juristësh kriminel serbë,

e cila zgjati deri para disa muajsh para fillimit të bombardimeve të NATO-së mbi ish Jugosllavinë. Deri atëherë kur diskriminohej e tërë popullata shqiptare në të gjitha sferat e jetës, e sidomos në denimet më drastike të shtetit serb ndaj shqiptarëve të pa fajshëm. Po, atëherë kur nuk kishte kurrëfarë drejtësie, atëherë kur ishte në këto anë dhe po sundonte shteti i aparthajdit serb. Në JAG ishim të angazhuar që të bënim punën e përkthyesit, por unë dhe Shahadija më tepër bëmë edhe punën e këshilltarëve për personelin ushtarak të kësaj njësie juristesh. -Në fillim më tepër u morrëm me përkthimet e kërkesave pronësore, të tokave të uzurpuara pas ngritjes së bazës ushtarake të Bondsteel'it, në Sojevë të Ferizajit.

Pas kryerjes së këtij dokumentacioni të pronësisë, vazhduam për një kohe edhe me shqyrtimin e lutjeve të pjesëtarëve të UÇK-së, në transformimin nga statuti i ushtarëve të UÇK-së në atë të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Në këtë kohë patëm rastin të vizitojmë shumë herë edhe kazermat e TMK-së në Gjilan dhe Ferizaj, ku edhe u njoftuam dhe biseduam me shumicën e ish eprorëve të UÇK's, e tani ishin eprorë të TMK-së me të cilët ne gjithmonë patëm një bashkëpunim shumë të mirë.

Me fillimin e punës së gjykatave, tani të pamvarura në Gjilan dhe Ferizaj, ne me Kapitenin Kovach pastaj Brian S. Hesline të tjerët e kishim për detyrë që të bënim këshillimin si dhe mbikqyrjen për zhvillimin e seancave të ndryshme gjyqësore, e në veçanti ato ndëretnike, me qëllim që mos të diskriminohej askush nga qytetarët në Kosovë nga lëmia e drejtësisë.

Gjatë kësaj kohe patëm rastin të merremi nga fillimi edhe me dy lëndë shumë të rënda, ku kryerësit e kimit ishin ushtarët amerikanë prej bazës së Bondsteel'it, e kurse viktima ishin: një vajzë 11 vjeçare nga fshati Debëllde edhe më vonë edhe vrasja nga pakujdesia e një djali 6 vjeçarë nga fshati Sllatinë e Epërme, e që të dy fëmijët e

familjeve shqiptare.

Pas krimeve që na ndodhën, njësia jonë JAG ishim të angazhuar që t'i bënim vizita të njëpasnjëshme familjarëve të viktimës Shabiu në Debëllde dhe asajë Rexhepi në Sllatinë të Epërme, që të dy të rrethit të Vitisë. Më tepër shkoni për në shenjë ngushllimi por edhe keqardhje për fatkeqësitë që u kishin shkaktuar ushtarët e Armatës Amerikane në Kosovë këtyre dy familjeve shqiptare. Për rastin e pare ishte përdhunimi dhe vrasjes së 11 vjeçares Merita Shabiu në Janar të vitit 2000, i akuzuari i së cilës ishte ushtari 36 vjeç Frank Ronghi i cili më vonë nga gjykata ushtarake në Werzburg të Gjermanisë, u denua me burg të përjetshëm.

Në lëndën e viktimës së 6 vjeçarit Gentrin Rexhepi, unë, Shahadija dhe Kapiteni i njësisë së JAG'ut ishim të angazhuar që prej fillimit, menjëherë pas ndodhjes së kësajë veprë. Për këtë vepër penale, gjatë gjykimit të ushtarit amerikan morrëm pjesë edhe ne si përkthyes; Shahadije Emini, Ajaz Emini dhe Mark Treshi së bashku me prindërit e të ndjerit, Deliu dhe Sanije Rexhepi dhe dajën e vogëlushit të ndjerë 6 vjeçar Gentrin. Morrëm pjesë ne seancë gjyqësore që po mbahej kundër të pandehurit ushtarit të Armatës Amerikane 19 vjeçarit Nicholas Joung, në Gjykatën Ushtarake të bazës së Armatës Amerikane në qytetin Gizen të Gjermanisë. Në këtë seancë të gjykatës së lartë ushtarake prindërit e Gentrin të vogël erdhën prej Kosovës vetëm e vetëm sa për t'i treguar gjykatësve ushtarak se po ia falin gjakun e të birit të tyre Ushtarisë Amerikane dhe Shtetit Amerikan për ndihmën që i dhanë në Çlirimin e Kosovës!

Ushtarin 19 vjeçar Nicholas Joung, të cilit i kishte ardhë edhe e ëma e tij nga Amerika në këtë seancë e që po gjykohej për këtë vrasje nga moskujdesia, familja shqiptare Rexhepi e falën. Ia falën gjakun e të birit të tyre para nënës së tij dhe të tërë trupit gjykues për aksidentin që i kishte ndodhur në vrasjen e të birit të tyre 6 vjeçar Gentrin. Ata gjykatës i kërkuan që ushtari Nicholas Joung të lirohej menjëherë nga akuza edhe mos të dënohej aspak!

Ishte një gjest i familjes Rexhepi që tërë trupën e gjykatës ushtarake të Armatës Amerikane në Gizen të Gjermanisë e lanë pa fjalë! Për këtë gjest human të familjes së viktimës, shkroi edhe shtypi amerikan se si familja e viktimës shqiptare në Kosovë e fali ushtarin amerikan për vrasje nga pakujdesia të birit të tyre 6 vjeçarë Gentrin Rexhepi!

Pas dy netësh qëndrimi në Gizen të Gjermanisë, pakë para përfundimit të gjykimit të ushtarit Nicholas Joung, ne me kapitenin dhe familjen e viktimës u nisëm me aeroplanin ushtarak C-17 për në Shkup, aty ku mbërritëm rreth orës 20:00.

Në bazën ushtarake të KFOR-it në Aeroportin e Shkupit, aty darkuam dhe pas orës 21:00 së bashku i gjithë grupi që ishim u nisëm me makinat tona ushtarake në drejtim të pikës kufitare të Hanit të Elezit. Në

pikën kufitare arritëm rreth orës 22:00, dhe pasi se me ne kishim edhe familjen e viktimës Rexhepi, policia maqedone i kërkoi pasaportat e udhëtimit të tyre, dokumente që nuk i kishin sepse UNMIK-u ende nuk kishte filluar me dhënien e dokumentacioneve të udhëtimit për banorët e Kosovës. Udhëtimi i tyre për në Gjermani ishte bërë vetëm me dokumentacionin që ia bëme nga komanda ushtarake në Bondsteel, por ky dokumentacion sa duket tani na qenka i pavlefshëm për policët sllavo-maqedon në kufirin e Bllacës. Po ndoshta aty ishin të njëjtë policë që maltretuan me mijëra e mijëra shqiptarë duke i plaçkitur dhe dëbuar nga forcat kriminale serbe!

Për shkak të dokumentacionit të familjes Rexhepi u detyruam që të gjithë të kthehemi përsëri për në kampin ushtarak të KFOR-it në Aeroportin e Shkupit. Aty ku edhe kaluam natën. Të nesërmen që të gjithë së bashku, dikur pas mesditës fluturoam mbi pikën kufitare të Bllacës drejtë bazës ushtarake Bondsteel në Kosovë, me helikopterin transportues ushtarak Chinook të Armatës Amerikane!...

Më herët shkrova pakë edhe për vizitën time derisa me Njësine e Forcave Speciale në fshatin Llashticë të Gjilanit, aty ku takuam edhe Kanadezen, Louis Arbou të Komisionit të Lartë për të Drejtat e Njeriut në OKB e cila po vizitonte grupin Kanadez të Forenstikës të cilët po bënin hetimet e krimeve serbe në këtë fshat të Kosovës.

Gjatë kësajë kohe me njësinë e juristëve JAG kishim marrë për detyrë që ta ndihmojmë edhe një vajzë të re 14 vjeçare e cila ishte viktimë nga masakra e fshatit Llashticë të Gjilanit. Për detyrë tani me JAG ishte që t'ia bëjmë

lejen e udhëtimit njëres nga viktimat e krimit serb në Llashticë. E ajo ishte vajza 14 vjeçare Vlora Shabani, personi i vetëm që kishte shpëtuar me plagë në fytyrë dhe në dorë nga ky krim. Ky krim kishte ndodhë vetëmse disa muaj para ardhjes tonë në Kosovë, më 13 Prill 1999, atëherë kur paramilitarët dhe ushtarët serbë kishin hyrë në fshat dhe kishin mbledhë 27 civil shqiptarë: gra, burra dhe fëmijë. I kishin pushkatu që të gjithë në një shtëpi, pastaj edhe ua kishin vënë zjarrin dhe i kishin djegë njerëzit e vrarë. Këtë e kishin bërë me qëllim të zhdukjes së provave të krimeve të tyre, siç kishte ndodhë edhe në shumë vendbanime të tjera me shqiptarë e Kosovës.

Nga ky grup u vranë 26 civil shqiptarë, 3 prej tyre ishin fëmijë të mitur e kurse e vetmja që kishte shpëtuar nga ky krim ishte Vlora Shabani. Në këtë masakër para syve të Vlorës i vranë: vëllaun e vogël të sajë, nënën, babin, gjyshin dhe shumë të afërm të tjerë, e kjo vogëlushe shpëtoi në mes të turmës së familjarëve të vrarë, ku mbeti e plagosur me plagë në fytyrë dhe në dorë!

Njësia ushtarake JAG kishte marrë përsipër që ta ndihmojmë Vlorën e cila kishte nevojë mjekësore dhe për rehabilitim. Vlorës 14 vjeçare, iu kishin kushtuar fejtone të tëra edhe nga shtypi amerikan, e sidomos në gazetën më prestigjioze të Amerikës "The New York Times"! Pas fejtoneve të shkruara në shtypin amerikan dhe duke e ditë gjendjen e Vlorës, shumë kush kishin shprehur dëshirën nga SHBA që ta ndihmojnë, por tani na kishin ardhë oferta që ta ndihmojnë edhe nga Kanadaja. Meqenëse oferta e ndihmës së parë që na erdhi në JAG ishte nga Kanadaja, menjëherë grupi ynë ia bëme lidhjen me Ambasadën Kanadeze në Vienë të Austrisë. Ata na premtuan se mbrenda disa

javësh, prej Viene të Austrisë do të dërgojnë në Prishtinë njërin nga përfaqësuesit e tyre për të marrë shenimet dhe për t'i rregullu Vlorës dokumentet e udhëtimit për në Kanada. Në ditën e takimit me personelin e Ambasadës Kanadeze në Prishtinë, pjesëtarët e njësisë JAG sollën Vlorën me axhën e sajë Nehat Shabanin në Bondsteel, dhe pastaj së bashku unë me Shahadijen dhe Kapitenin Brian S. Heslin u nisëm për në vendëtakimin në Prishtinë. Në Prishtinë ne u takuam në kohën e planifikuar me personelin e Ambasadës Kanadeze që të takohemi në Hotelin "Grand", kurse Shahadija gjatë kësajë kohe shkoi të vizitojë dajën e sajë që ishte krejtë afër Hotelit "Grand" për shkak se nuk kishim nevojë për të dytë.

Personeli i Ambasadës Kanadeze që takuam ishte zotëri Robert Mc Leman, Sekretar i parë në Ambasadën Kanadeze në Vijenë të Austrisë. Ishte një zyrtarë i moshës mesatare, dhe pa humbë aspakë kohë filloi me mbledhjen e informacioneve të duhura të tyre dhe na premtoi aty që mbrenda disa ditësh Vlorë me axhën e saj Nehatin do të kenë dokumentacionin e duhur për të udhëtuar për në Kanada. Pas përfundimit të detyrës me përfaqësuesin kanadez, përsëri që të gjithë ne së bashku me makinat ushtarake shkuaam para shtëpisë së dajës së Shahadijes edhe e morëm edhe atë. Pastaj, vazhduam rrugën për në Bondsteel. Por gjithsesi na duhej për t'i dërgu në shtëpinë e tyre në fshatin Llashticë edhe Vlorën me axhën e sajë Nehatin.

Pas disa ditësh Kapiteni Heslin më tha se ishte tepër i mërzitur për rastin e Vlorës, sepse dikush kishte ardhë prej SHBA-së edhe e kishte marrë Vlorën për shërim në Amerikë! Ishte i mërzitur sepse nuk dinte se ç'ti thotë atyre të Ambasadës Kanadeze që kishin

ardhë special për të prej Viene të Austrisë, e tani kur gati se gjithëçka i bëme gati për udhëtimin e tyre na doli ky farë zhgënjimi! Më tha se ishte mërzitur më tepër sepse ata të Ambasadës Kanadeze në Austri ndoshta do të mendonin se kjo e tëra ishte bërë me dijeninë tonë, edhe pse ne nuk kishim kurrëfarë dije dhe lidhje më tepër derisa na lajmëruan se Vlorë udhëtoi për në Amerikë.

Gjatë kohës sa po punonim me Armatën Amerikane në Kosovë, ne sollëm në familjen e vëllaut tim e tani të ndërë Murtezanit në fshatin Llojan të Kumanovës edhe dy vajzat e tona; Liridonën 7 vjeçare dhe Mimosën 6 vjeçare, kurse shtëpinë në Cleveland të Ohio's së SHBA's ua kishim lënë në shfrytëzim refugjatëve, familjarë të posa ardhur nga Kosova dhe Maqedonia.

Me këto lëvizje tona ne tani po planifikonim edhe kthimin tonë të përhershëm në trojet tona që i kishim lënë para 20 viteve, nga koha e ish Jugosllavisë. Në Shtator të 1999, Liridona dhe Mimoza filluan mësimin, por kësajë here në gjuhën shqipe ku në fillim do ta kenë vështirë për derisa të adaptohen. Vajzat po shkonin po në të njëjtën shkollë në "Rilindja" të Llojanit, aty ku unë para shumë dekadash fillova shkollimin tim fillor. Fillimi i tyre në Llojan nuk ishte aq i lehtë, nuk ishin mësuar të jenë largë neshë, si dhe transferimi prej mësimin në gjuhën angleze në shqipe, edhe pse në shtëpinë tonë në Amerikë gjithmonë është folur vetëmse shqip!

Në Llojan vajzat u adoptuan shpejtë, sepse aty kisha nënën time me familjen e vëllaut që kujdeseshin për to, si dhe familjen e gjërë me shoqërinë e tyre të re. Gjatë kësajë kohe mua me Shahadijen, njësia jonë ushtarake JAG që po punonim tani një kohë, na thanë poqëse doni të shkoni dhe të vizitoni vajzat tuaja në Maqedoni, mundë ta bëni pas punës së ditës së Premte por me kusht që të Hënën në mëngjes të jemi në punë, por edhe që mos të bëhet e madhe dhe mos t'i tregojmë as punëdhënësit tonë TRW!

Ky ishte një lehtësim i madh për ne sepse prej bazës ushtarake në Bondsteel të Sojevës, për në bazën ushtarake në Aeroportin e Shkupit kishim udhëtimin me autobusin e rregullt dy herë në ditë. Një herë në mëngjes dhe pastaj në mbremje që po bartë ushtarët dhe pjesëtarët e kompanisë Amerikane "Brown & Root", që po mirreshin me rregullimin dhe mirë- mbajtjen e bazave ushtarake në Kosovë dhe Maqedoni. Por edhe për fat tonin, kishte punishten e tyre edhe në afërsi të stacionit hekurudhorë në Kumanovë.

Tani me këtë leje udhëtimi shumë gjëra u bëne shumë më të lehta për ne si familjarë, na u dha mundësia që pas pune, vikendin të shkojmë e ta kalojmë të gjithë së bashku me të gjithë familjen në Llojan. Pas disa muajsh blemë edhe një makinë nga një i afërm i yni me të cilën gjithëçka u lehtësua edhe më tepër për ne



artilери, tanke, mina hedhës si dhe helikopterët ushtarak. Së pari sulmi maqedon filloi mbi fshatrat: Vaksincë, Sllupçan, Orizare dhe Hotël. Pas dy javë lufte të rreptë të UÇK-së me forcat maqedone, fshatrat shqiptare granatohen pamëshirshëm: Llojan, Vaksincë, Sllupçan, Orizare, Likovë, Hotël, Mateç e deri në Haraçinë. Kurse më 26 Maj 2001 në fshatin Vaksincë vritet heroi i kombit Fadil Nimani Komandant Tigri, i cili ishte veteran i luftës së UÇK-së në Kosovë e tani kishte ardhë nga Kosova për t'i ndihmuar vëllezërit e tij shqiptarë në rrethin e Kumanovës. Gjatë kësaj kohe, rruga për në fshatrat shqiptare rrëzë maleve të Karadakut ishte mbyllur. Vajzat na mbetën në fshatin Çerkez te motra, kurse nëna e sëmure, familjarët tjerë në fshatin Llojan.

Tani po pritej nga momenti në moment që edhe në fshatin Çerkez të fillojnë luftimet. Në një anë, rreth stacionit hekurudhorë të Kumanovës, përballë fshatit Çerkez mbi silosin e betonit shifeshin snajperistët maqedon që ishin të gatshëm për gjuajtje në popullatën e pa mbrojtur shqiptare. Ndërsa vetëm disa qindra metra më tutje, gjendej edhe kazerma ushtarake maqedone e cila ishte në gjendje gadishmërie, e kurëse në anën tjetër kishte disa pjesëtarë të UÇK-së që vinin rregullisht në ndejt tona, ku ishim me dhëndërrin Sabri Asani -Drejtor Shkollë, Feriz Dervishin - Këshilltarë Komunal dhe biznesmen i madh si dhe shoqëria e tyre, për t'i kërkuar lejen e fillimit të aksionit luftarak edhe në këtë fshat. Mirëpo ishte Feriz Dervishi ai i cili rregullisht e përmbajti kontrollin e pjesëtarëve të UÇK's po dhe të forcave maqedone, për mos shpërthimin e një lufte shumë të përgjakshme të popullatës së pa armatosur në fshatin më të madh të komunës së Kumanovës e cila është banuar kryesisht me shqiptarë, dhe pothuajse lagje e qytetit.

Meqenëse nuk mundë të shkoja në fshatin Llojan, tani vikendet po i kalonim së bashku në fshatin Çerkez te motra me dhëndërrin Sabriu dhe familjen e tyre. Gjatë mbrëmjeve sa ishim në fshatin Çerkez kohën më të gjatë po e kalonim së bashku me shoqërinë e Sabriu mbrenda fshatit. Prej fshatit Çer-kez patëm rastet e shumëta që t'i shohim edhe granatimet e pa mëshirëshme të fshatrave tona shqip- tare që ishin për ballë, nga forcat sllavo maqedone.

Te motra kishim edhe vajzat tona që mbetën të ngjuara në fshatin Çerkez, sepse dokumentacioni me veshëmbathjen e tyre i mbeti në zonën e çliruar të Llojanit! Gjatë vikendit vendosëm që vajzat t'i transferojmë në Kaçanik te familja e Shahadijes, mirëpo si t'ia bëjmë?! Ato nuk kishin pasaportat me vetë! Tani po flitej se edhe rruga për në fshatin Çerkez do të mbyllej, atëherë në mbremje vonë morëm vajzat edhe u nisëm për në qytetin e Kumanovës te kusherira Mifiraja, aty kaluam natën dhe të nesërmen para darke të Dielën më 6 Maj 2001, u nisëm drejtë

kufirit të Elez Hanit.

Në kufi ishte pamje e trishtueshme, kallaballëk i madh, plotë gra edhe fëmijë që më tepër i përngjante kohës kur shqiptarët po iknin dhe dëboheshin nga Kosova për në Maqedoni por tani ishte e kundërta, hqiptarët po iknin prej Maqedonisë për në Kosovë! - Në zonën kufitare unë nxorra kamerën edhe po bëja disa inçizime të refugjatëve që po iknin për në Kosovë kur nga ana tjetër më bërtiti policia kufitare maqedone: "Çka je duke bërë, a e dinë se nuk lejohet inçizimi në kufi?" Unë ia prita anglisht: "Kush po të pyet ty?" Polici maqedon gadi sa s'u çmendë, tani ma kërkonte kamerën që të ma marrë sepse paskam thyer ligjin e tyre. Unë i thashë se: "Kamerën nuk ta jap, kjo është e imja!" Policin gadi sa nuk iu muar zëri nga piskama duke e kërkuar që t'ia japë kamerën atij, ishim të parët në kolonë të qindra makinave pas neshë, dhe kishim bërë bllokim total të trafikut kufitarë. Tani polici nuk na lejonte që të kalojmë kufirin por ai më thonte se: "Ju nuk keni për ta kalu kufirin nëpërmjet kësaj pike kufitare, por tani ju duheni të ktheheni në pikën kufitare të Tabanocit". Unë ia ktheva se: "Unë kamë për të kaluar vetëm këtu e askund tjetër", atëherë polici hyri mbrenda edhe e thirri shefin e tij i cili ishte një polic tjetër i cili na u afrua edhe më pyeti se çka është problemi? I thashë "Nuk e kuptoj se çka është çmendur ky kolegu juaj, e s'po don me na lënë që të kalojmë në rrugën tonë për në punën tonë në Bondsteel." Polici u afrua edhe po i tregonte si unë kisha inçizu mbrenda kufirit, unë ia prita: "Nuk është aspakë e vërtetë, eja shife aparatin, ky është aparat fotografik e jo kamerë inçizuese"! Shefi i policisë u afrua edhe e pa se ishin foto që kisha fotografu në vende tjera, edhe mu drejtua me fjalë të mira; "Të lutem ta kesh parasysh e mos fotografo në zonën kufitare sepse është e ndaluar. E shef atje shenjën më largë ku të tregon se është zonë e ndaluar për të bërë foto këtu", edhe na e hapi krahun e rrugës edhe kaluam në anën tjetër të kufirit, në anën Kosovare, pa pasaportat e Liridonës dhe Mimoze. Sa për kamerën, ajo ishte në realishtë kamerë që kisha bërë inçizime, por kishte edhe pullën tjetër që të bëja edhe vetëmse fotografi. Ato të cilët edhe ia tregova shefit të policisë në kufi!

Ky ishte fati jonë, sepse po theja të gjitha ligjet, po bëja kalimin ilegal pa dokumente si dhe inçizime mbrenda zonës së ndaluar kufitare. Si duket uniformat dhe kartelat tona ushtarake të Armatës Amerikane po e bëjnë të veten.

Në pjesën kufitare të Kosovës na qëlloi një polic i Kaçanikut i cili njihnte familjen e Shahadijes, pasi se na pa se kush ishim filloi të na pyes se si po kalonim, dhe kur na pa me uniformën e Ushtrisë Amerikane as që na kërkoi dokumentat e udhëtimit, as për ne e as për vajzat tona, përveçse që na përshëndeti dhe dëshiroi rrugë të mbarë.

Pasi kaluam kufirin shkuam në Kaçanik në shtëpinë e vëllaut të



Shahadijes, mikut Maksut Hoxha, aty ku tani ishte duke e shfrytëzuar shtëpinë djali i hallës së Shahadijes Haki Raka me familjen e tij, i një familje të madhe intelektualësh. I lamë vajzat tona aty dhe ne vazhduam për në kampin ushtarak të Bondsteel'it. Kjo na ishte një ditë që nuk do të harrohet kurrë, dhe me shumë fate...

Në ditën e shtunë më 23 qershor 2001, derisa po udhëtoja me makinë prej Sojeve për në fshatin Çerkez të Kumanovës, menjëherë pas daljes nga qyteti i Shkupit në autostradën për në Kumanovë tek urat mbi autostradë, pashë shumë turmë njerëzish të mbledhur dhe kohë pas kohe po rrehnin shuplakë. Pasi kalova hotelin "Belevue", aty pashë edhe shumë makina. Disa qindra metra më tutje edhe unë dola në të djathtë nga rruga kryesore dhe parkova makinën anash dhe dola jashta makine për të parë se ç'po ndodhte. Disa qindra metra më tutje në fushën përballë me vreshta, kishin qenë disa tanka të renditura në formë harkore të cilat kohë pas kohe po guanin në mënyrë të sinkronizuar në drejtim të fshatit Haraçinë i cili fshat shihej në anën e majtë të rrugës kryesore disa kilometra më tutje rrëzë kodrinave të fshatit. Përveç sulmit me tanke që po sulmohej Haraçina, po sulmohej edhe me artileri të rëndë si dhe nga ajri sulmohej me dy helikopterët luftarak MI-24 që sapo i kishin marrë Maqedonia nga Ukraina. Çdo herë që gjuhej nga artileria apo helikopteri luftarak i forcave maqedone, e gjithë turma e atyre njerëzve kërcenin dhe rrehnin shuplakë nga gëzimi, kurse në anën tjetër pas çdo krisme shifej tymi dhe

pluhuri ku qëllohej fshati Haraçinë. I gjithë fshati ishte në një pozitë të tillë që dukej sikurse të pozicionohej në shuplakën e dorës. Në atë vend qëndrova i ngjuar dhe i habitur për 10-15 minuta, dhe pastaj hyra në makinë dhe vazhdova rrugën në drejtim të Kumanovës. Gjatë rrugës po mendoja dhe po i bëja pyetje vetëvetes a thua si do të shpëtojnë pjesëtarët e UÇK-së dhe fshatarët e pa fajshëm që të gjitha këtyre granatimeve të çmendura të ushtrisë dhe policisë maqedone?

Në të arritur te motra në Çerkez i tregova Sabriu (dhëndërrit) se ç'po ndodhte, dhe menjëherë e dhezëm televizorin dhe pamë se në orën 15:00 i kishin ndërpre luftimet sepse në Hotelin "Belevue" të gjitha ato makina që i pashë, kishin qenë udhëheqja maqedone në pritje të Javier Solanës Përfaqësues i punëve të Jashtme të Bashkësisë Evropiane. Gjatë këtij takimi ishte bërë edhe marrëveshja për ndërprerjen e të gjitha luftimeve, dhe ishin marrë veshë me envojin special të SHBA's Peter Feith, që pjesëtarët e UÇK's së bashku me të lënduarit dhe të vranët, si dhe me armatimin e tyre të ndihmohen nga pjesëtarët e Armatës Amerikane që të tërhiqen në zonën e tyre të lirë, në fshatin Nikushtak!

Evakuimi i pjesëtarëve të UÇK-së nga pjesëtarët e Armatës së SHBA-së filloi në të njëjtën ditë në orën 17:00, dhe mbrenda një kohe të shkurtër që të gjithë luftëtarët e UÇK-së u larguan nga fshati Haraçinë. Të nesërmen trupat maqedone hyjnë në fshatin e boshadisur, pa asnjë pjesëtarë të UÇK-së.


Në lidhje me këtë fenomen i kemi disa kontradikta ku thuhet se Kryetari maqedon Trajkovski kishte frigën se po fillonte një luftë

civile në Maqedoni, ky ishte një verzion, por sipas tjetrit thuhet se Sekretari i Përgjithshëm i NATO-së Lord George Robertson kishte thënë se sulmi maqedon kundër UÇK-së në fshatin Haraçinë ishte "çmenduri" dhe "krejtësisht i pa imagjueshëm" dhe i kishte tërheqë vërejtjen se "Maqedonia ishte në prag të një lufte të përgjakshme civile."

Meqenëse trupat e UÇK-së ishin të rrethuar në tre anë e fshatit, dhe tani nuk kishin as ushqim dhe as municion sa duhet, mendohej se ata tani për sulm do të përdorin mortajat 120 mm. dhe nga të cilat do të arriheshin caqe të sulmit si: aeroporti, rafineria, stacionet policore si dhe të gjitha pikat më vitale në Shkup, duke përfshi edhe Parlamentin e Maqedonisë. Ky ishte kërcënim të cilin ia kishte bërë qysh në fillim të luftimeve Komandant Hoxha, komandant për Forcat e UÇK-së në fshatin Haraçinë.

Edhe kjo luftë e UÇK-së me shtetin maqedon, nuk ishte aspakë e barabartë. Për derisa forcat e UÇK- së kishin ushtarë nga popullata lokale me një numër të kufizuar të luftëtarëve, gjithashtu edhe të luftëtarëve të ardhur nga Kosova dhe Shqipëria. Thuhet se që të gjithë përbënin rreth 6.000-7.000 ushtarë, dhe me armatim të thjeshtë: Kallashnikov të vjetër dhe disa minahedhës. Kurse pala maqedone përbëhej prej ushtrisë së rregullt, rezervistëve ushtarak, policisë, luftëtarëve nga Ukraina, Serbia dhe Bullgaria e që numronin rreth 15.000-20.000 ushtarë dhe police që kishin armatim shumë më të sofistikuar si: artileri të ndryshme, tanke, autobllinda, automjete ushtarake dhe helikopter luftarak, si dhe kishin ndihma të mëdha në armatim dhe personel edhe nga Bullgaria, Serbia, Ukraina dhe Turqia.

Çfarë është 'Kompleksi i Edipit' dhe si reflektohet ai në marrëdhëniet e sotme



"Kompleksi i Edipit" është një koncept i prezantuar nga Sigmund Frojd, pjesë e teorisë së tij të fazave psiko-seksuale të zhvillimit, që përshkruan një dëshirë për përfshirje seksuale me prindin e gjinisë së kundërt, dhe një ndjenjë xhelozie dhe rivaliteti me prindin e së njëjtës gjini.

Kjo fazë e zhvillimit të konfliktit të madh, supozohet se ndodh tek djemtë e moshës 3-5 vjeçare. Ky term është emërtuar sipas personazhit kryesor të tragjedisë "Edip mbret" nga Sofokliu. Në këtë tragjedi të lashtë greke, Edipi braktiset nga prindërit e tij që kur ishte foshnje.

Më vonë, në moshë madhore, ai bëhet mbret i Tebës dhe pa e ditur vret babanë e tij dhe martohet me nënën e tij. Analogu femëror i termit psiko-seksual është "Kompleksi i Elektrës", i quajtur kështu sipas një figure tjetër mitologjike tragjike që ndihmoi në vrasjen e nënës së saj.

Edipal është termi i përgjithshëm për të dy komplekset. Shpeshherë këto teori interpretohen si prirje e burrave për të zgjedhur gra që ngajnë si nënat e tyre, ndërsa gratë zgjedhin burra që u ngajnë baballarëve të tyre. Të dy komplekset u cilësuan si të diskutueshme që kur u prezantuan për herë të parë në publik në fillim të shekullit XX-të. Kritikët e Frojdit thonë se ka shumë pak prova empirike që vërtetojnë vlefshmërinë e teorisë. Megjithatë, bazamenti i kësaj teorie konsiderohet ende si një gur-themeli i psikanalizës edhe sot e kësaj dite. Sipas Frojdit, zhvillimi i personalitetit në fëmijëri zhvillohet gjatë 5 fazave psiko-seksuale: fazat orale, anale, fallike, latente dhe gjenitale.

Në çdo fazë, energjia seksuale shprehet në mënyra të ndryshme dhe përmes pjesëve të ndryshme të trupit. Secila prej

këtyre fazave psiko-seksuale, shoqërohet me një konflikt të veçantë që duhet zgjidhur për të kaluar me sukses dhe në mënyrë të shëndetshme në fazën tjetër. Mënyra se si zgjidhet çdo konflikt, mund të përcaktojë personalitetin dhe marrëdhëniet e një personi në moshën madhore. Kompleksi Edipal, i prezantuar nga Frojdi në vitin 1899 në veprën e tij "Interpretimi i ëndrrave", ndodh gjatë fazës fallike të zhvillimit (mosha 3-6 vjeç), një periudhë kur një fëmijë ndërgjegjësohet për dallimet anatomike seksuale, duke vënë në lëvizje konfliktin midis tërheqjes erotike, rivalitetit, xhelozisë dhe pakënaqësisë.

Në mënyrë të pandërgjegjshme, djali i vogël ndihet i lidhur seksualisht me nënën e tij. Zilia dhe xhelozia drejtohen ndaj babait, objekt i dashurisë dhe vëmendjes së nënës. Frojdi besonte se një djalë i vogël është i dënuar të ndjekë dëshirat e tij, në të njëjtën mënyrë siç u dënua të bënte edhe Edipi i Sofokliut. Ndjenjat armiqësore ndaj babait shkaktojnë frikën nga tregdhja, që është frika irracionale si ndëshkim për dëshirën ndaj nënës së tij. Për ta përballuar këtë ankth, i riu nis të identifikohet me babain, duke adoptuar qëndrime, karakteristikë dhe vlera që babai i quan të tijat. Me fjalë të tjera, babai kalon nga rival në një model.

Pikërisht nëpërmjet këtij identifikimi me agresorin, djali zgjidh fazën fallike të zhvillimit psiko-seksual dhe e fiton "superegon" e tyre, një grup vlerash që e dominojnë mendjen e ndërgjegjshme të të rriturit. Në këtë proces, fëmija heq dorë më në fund nga ndjenjat seksuale ndaj nënës, duke i transferuar ato në figura të tjera femërore.

Por pasoja është se tejkalimi i Kompleksit të Edipit dhe reagimet që pasojnë, përfaqësojnë arritjen më të

rëndësishme shoqërore të mendjes njerëzore, thotë Frojdi. "Kompleksi i Edipit është bërthama e neurozave dhe përbën pjesën thelbësore të përmbajtjes së tyre. Ai përfaqëson kulmin e seksualitetit infantil, i cili, me pasojat e tij, ushtron një ndikim vendimtar në seksualitetin e të rriturve" - theksonte më tej ai.

Zhvillimi analog psiko-seksual i Frojdit për vajzat e vogla përfshin Kompleksin e Elektrës, që nis që në momentin që vajza kupton se i mungon penisi. Për këtë fajësohet nëna, dhe ajo bëhet objekt i inatit të vajzës. Në të njëjtën kohë, kjo e fundit zhvillon ndjenjat e dëshirës seksuale ndaj babait të saj.

Fakti që nëna merr dashuri nga babai, ndërsa ajo jo, bën që vajza të bëhet xheloze për nënën e saj, e cila tashmë shihet si rivale. Ashtu si djemtë e vegjël që duhet të kapërcejnë Kompleksin e Edipit, vajzat e vogla e zgjidhin këtë konflikt duke hequr dorë nga ndjenjat incestuale dhe rivaliteti, duke u identifikuar me nënën, dhe duke zhvilluar kësajsoj superegon.

Megjithatë, Frojdi nuk ishte në gjendje të formonte një teori komplekse për zgjidhjen e konflikteve për Kompleksin e Elektrës, siç bëri për kompleksin e Edipit. Tek djemtë, zgjidhja e shtytjes Edipale motivohet nga frika e tregdhjes. Por Frojdi nuk ishte në gjendje të gjente një nxitje po aq të fuqishme tek vajzat e vogla, edhe pse arsyetoi se ajo mund të motivohej nga shqetësimet për humbjen e dashurisë së prindërve të saj.

Edhe pse Kompleksi i Elektrës i atribuohet shpesh Frojdit, ai u propozua në fakt nga nxënësi i tij, Karl Jung. Frojdi arsyetoi se nëse konflikti që lind nga kompleksi Edipal nuk zgjidhet me sukses, kjo mund të shkaktojë "neuroza", të cilat ai i përcaktoi si manifestime të materialit të pavetëdijshëm që prodhon

ankth.

Djemtë mund të bëhen tepër konkurrues me burrat e tjerë, duke projektuar rivalitetin e tyre të fshehtë me baballarët e tyre dhe mund të fiksohen pas nëna, duke kërkuar gra që i ngajnë asaj. Ndërkohë, vajzat që nuk e mposhtin zilinë e mospasjes së organit mashkullor mund të zhvillojnë një kompleks mashkulloriteti kur të rriten, duke pasur probleme me intimitetin me burrat në moshë madhore.

Pra, ajo mund të përpiqet të rivalizojë burrat duke u bërë shumë agresive. Meshkujt me të cilët ajo ndërvepron ngushtë i ngajnë shpesh babait të saj. Për më tepër, duke qenë se identifikimi i vajzave me nënat e tyre është më i dobët se i djemve me baballarët e tyre (të cilët kanë ankthin e tregdhjes), superegoja femërore është më e dobët dhe për rrjedhojë, identiteti i tyre si individë të veçantë, të pavarur është më pak i zhvilluar.

Frojdi e shpjegoi teorinë e tij të kompleksit Edipal duke përdorur një rast të vetëm studimor, atë të "Hansit të Vogël", djalit 5-vjeçar që kishte fobi ndaj kuajve. Rreth moshës 3-vjeçare, Hansi i vogël tregoi interes për penisin e tij por edhe të meshkujve të tjerë, përfshirë kafshët. Nëna e tij e alarmuar e kërcënoi se do t'ia priste penisin nëse ai nuk ndalonte së luajturi me të. Por pikërisht në atë kohë, ai zhvilloi një frikë të panatyrshme nga kuajt. Frojdi arsyetoi se djali i vogël iu përgjigj kërcënimit të nënës së tij për tregdhje duke pasur frikë nga kuajt dhe organet e tyre gjenitale të mëdha.

Fobia u zbut kur Hansi nisi të ndërvepronte me kuajt, kur këtyre iu vendos mbi hundë një parzmore e zeze që kishte qime të zeza rreth gojës, gjë që babai i tij sugjeroi se simbolizonte mustaqet e tij. Në interpretimin e Frojdit, frika e Hansit nga kuajt

përfaqësonte në mënyrë të pandërgjegjshme frikën e tij ndaj babait të tij.

Megjithëse rasti i studimit të Hansit të Vogël ilustron në mënyrë të përsosur (dhe shumë të përshtatshme) teorinë e Frojdit për Kompleksin e Edipit, ky është një rast i vetëm dhe i pamjaftueshëm për të përgjithësuar rezultatet për popullatën e gjerë.

Për më tepër Frojdi e takoi Hansin vetëm një herë, dhe informacioni rreth tij i erdhi vetëm nga babai i Hansit, i cili ishte një admirues i hapur i punës së Frojdit. Edhe nëse Hansi (emri i vërtetë i të cilit ishte Herbert Graf) vuanë vërtet nga një Kompleksi i Edipit, kjo nuk do të thotë se ai është universal siç pretendonte Frojdi.

Për shembull, në vitin 1929, shkencëtari polako-britanik Bronisllav Malinowski, që konsiderohet gjerësisht si babai i antropologjisë moderne, kreu një studim etnografik tashmë të famshëm në ishujt Trobriand në Oqeani, ku baballarët nuk janë aspak të përfshirë në disiplinimin e bijve të tyre.

Në këtë shoqëri, marrëdhënia midis babait dhe djalit ishte gjithmonë e mirë. Disiplinori në popullatat Trobriand është xhaxhai, që e hdh poshtë Kompleksin e Edipit. Edhe shkrihtarja psikoanalitike Klara Tompson kritikoi qëndrimin e Frojdit ndaj grave, që sipas saj është i njëanshëm.

Ideja e Frojdit se zilia e penisit ka bazë biologjike, mund të shpjegohet më mirë me zilinë e përgjithshme që kanë vajzat ndaj djemve, sepse shpeshherë i mungon i njëjti nivel lirie në moshën e re dhe mundësitë në moshë madhore. Dhe e gjitha kjo do të thotë se kompleksi Edipal i Frojdit ka shumë të meta dhe në rastin më të mirë, mund të zbatohet për një përqindje të vogël të popullsisë së përgjithshme. / ZMEscience - bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova nuk ndryshon në renditjen e FIFA-s, Shqipëria bie për dy pozita

PRISHTINË, 6 PRILL - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll nuk ka ndryshuar pozicionin, pasi edhe pas dy ndeshjeve të muajit mars renditet në vendin e 107. Siç

dihet, "dardanët" barazuan në dy ndeshjet e para kualifikuese "Euro 2024", ndaj Izraelit (1-1) dhe Andorrës (1-1). Në anën tjetër, Shqipëria luajti vetëm

një ndeshje dhe e humbi ndaj Polonisë (1-0), prandaj ka rënë edhe për dy pozita në renditjen e FIFA-s. Tash kuqezinjtë renditen në pozitën e 68. Argjentina e Leo

Messit është rikthyer në majat e futbollit botëror duke u pozicionuar e para. Kjo vjen pas fitoreve në dy miqësoret kundër Panamasë dhe Curachao.



Kelmendi, Gjakova dhe Krasniqi gradohen me titullin kolonelë në Ushtrinë Shqiptare

PRISHTINË, 6 PRILL - Trajnerja e xhudos, Majlinda Kelmendi dhe xhudistet Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova, të enjten janë graduar me titullin "Kolonelë" në ushtrinë Shqiptare. Trajneri më i mirë në botë, Driton Kuka, është shprehur i lumtur, derisa në profilin e vet në "Facebook" ka shpërndarë fotografinë ku tri vajzat nga Kosova janë me uniformën e Ushtrisë Shqiptare. "Me kolonelet e Ushtrisë Shqiptare. Ceremonia e gradimit në Ministrinë e Mbrojtjes Shqiptare! Krenar", ka shkruar Kuka. Përveç Kelmendit, Gjakovës dhe Krasniqit, pjesë e Ushtrisë Shqiptare me gradën kolonelë janë bërë edhe shumë sportistë të tjerë elitare nga Republika e Shqipërisë. Këtë ditë e ka quajtur historike për Ushtrinë Shqiptare kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, duke

shtuar se veçantia e kësaj ngjarje është se në këtë grup janë edhe tri kampionet olimpike nga Kosova, Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova. Ai ka thënë se tani e tutje këta sportistë do të kenë të njëjtin mision, të njëjtat ambicie dhe vullnete në funksion jo më vetëm të sportit, por edhe të forcave të armatosura. "Sot është një ditë realisht historike për sportin shqiptar dhe për Forcat e Armatosura Shqiptare, sepse sot pjesë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë bëhen një grup sportistësh dhe sportistesh që flamurin kombëtar e kanë ngritur në majën më të lartë në skenën e sportit botëror apo evropian. Dhe është një ditë krejt e veçantë sepse në këtë grup bëjnë pjesë edhe tri kampione shqiptare nga Kosova të cilat nga sot e tutje do të jenë bashkë me kampionet dhe kampionët shqiptarë nga Shqipëria, nën



të njëjtin flamur, për të njëjtin mision, me të njëjtat ambicie dhe vullnete të bashkuar në

funksion jo më vetëm të sportit, por edhe të forcave të armatosura", ka thënë Rama,

i cili ka kujtuar momentin kur u vizitua vitin e kaluar nga të artat e Kosovës së bashku me trajnerin e tyre Driton Kuka, duke theksuar se kërkesa e tyre e vetme ishte që të pajiseshin me pasaportë të Shqipërisë. "Një nga kujtimet më të bukura të gjithë kësaj periudhe që unë kam pasur dhe kam privilegjin e jashtëzakonshëm dhe nderin e madh të jem në krye të qeverisë dhe ky kujtim lidhet me vizitën që më bën dy kampionet olimpike të Kosovës së bashku me trajnerin e tyre, kryemjeshtrin Driton Kuka në verën e shkuar kur patën mirësinë që unë nuk do ta harroj kurrë të vinin së bashku me medaljet e tyre të arta dhe e vetmja gjë që kërkuam prej meje ishte t'u jepej mundësia të bëheshin qytetare të Republikës së Shqipërisë, të merrnin pasaportën kuq e zi të Republikës së Shqipërisë", ka shtuar Rama.

Rrahmani vazhdon kontratën me Napolin deri në vitin 2027



NAPOLI, 6 PRILL - Kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani, ka arritur marrëveshje për zgjatjen e kontratës deri në vitin 2027 me opsion qëndrimi edhe për një vit tjetër. Zyrtarizimi i nënshkrimit të kontratës së re pritet të bëhet zyrtar shumë shpejt, shkruan "Sky Sport".

"Qëndërmbrojtësi kosovar ka arritur marrëveshje me skuadrën e Napolit për të vazhduar deri në vitin 2027, me opsionin e vazhdimet edhe për një sezon. Asgjë nuk mungon në këtë marrëveshje, ndërsa njoftimi zyrtar pritet të bëhet shumë shpejt", ka shkruar ky medium.

29-vjeçari ka zhvilluar 26 paraqitje në të gjitha garat me Napolin këtë edicion, ku ka shënuar dy gola, ndërsa e ka edhe një asistim. Rrahmani me Napolin është afër titullit të parë pas një periudhe të gjatë, ndërsa është edhe në çerekfinale të Ligës së Kampionëve.

Agjenti i Kumbullës: Shqipëria do të thotë shumë për Marashin

ROMË, 6 PRILL - Nuk është preferencë për Jose Mourinhon, por ky detaj ka pak rëndësi për drejtuesit e Romës, të cilët i kanë ofruar Marash Kumbullës rinovimin e kontratës. Gianni Vitali, agjenti i qëndërmbrojtësi

kuqezi, ka zbuluar disa prapaskena interesante përpara kalimit të tij në kryeqytet. "Napoli ishte i interesuar për të në janar 2021, por Kumbulla dëshironte ta mbyllte sezonin me Veronan. Më pas në verë

kishte një interesim të madh nga të gjitha ekipet "big" të Serisë A, por Roma ishte ekipi më i vendosur", u shpreh agjenti i Kumbullës duke u ndal më pas te përfaqësimi i tij me përfaqësuesen shqiptare:

"Debutoj shpejt me përfaqësuesen e Shqipërisë. Pas disa ditësh zhvilloi një ndeshje të mirë me Poloninë. Sigurisht që kombëtarja për të përfaqëson diçka të madhe. Shpresoj të arrijë disa objektiva që kanë".



Ancelotti: Dominuam ndaj Barcelonës në çdo drejtim

MADRID, 6 PRILL - Carlo Ancelotti, trajner i Real Madridit, pas fitores ndaj Barcelonës (0-4) në "Camp Nou", ka thënë se skuadra e tij bëri një ndeshje të madhe dhe se ka qenë e kompletuar në çdo drejtim. "Kemi bërë një ndeshje të madhe, kemi qenë

të kompletuar në çdo drejtim. Vetëm kështu mund të fitosh 0-4 në këtë fushë, në këtë stadium. Gjithsesi nuk ka qenë dhe aq e lehtë sa rezultati tregon. Kemi pasur vështirësi në daljen me top, sidomos në pjesën e parë. Unë mendoj se goli i Viniciusit në fundin e

pjesës së parë ndryshoi të gjithë dinamikën e ndeshjes. Në tërësi ka qenë një ndeshje me personalitet nga ana jonë. Pastaj përvoja ka bërë të vetën, ka rezultuar vendimtare. Energjia e të rinjve dhe përvoja e veteranëve ishin çelësi i fitores", ka thënë Ancelotti. "Më

vjen mirë që gjej Osasunën në finale. Ia pata thënë trajnerit të tyre në shkurt me shaka, por ndonjëherë shakatë dalin të vërteta. Mendoj se meritojmë një festë të vogël pas këtij triumfi, sepse ishte shumë e rëndësishme arritja në finale", ka shtuar Ancelotti.



Godelli: Shteti më ka harruar, kam fituar 50 medalje

TIRANË, 6 PRILL - Shtatë nga sportistët elitarë të Shqipërisë dhe të Kosovës në shumë sportesh u vlerësuan të enjten nga Qeveria e Shqipërisë me gradën "kolonel", duke qenë pjesë e Forcave të Armatosura. Në lidhje me këtë vendim ka reaguar edhe Daniel Godelli, peshëngritësi që ka fituar 50 medalje dhe ka ngritur lart flamurin kuqez. "Trishtim", thotë peshëngritësi, që duket se është harruar nga shteti. "Marr shkas nga ceremonia e dekorimit të 7 sportistëve 'Elitarë' si pjesë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Po shikoj sot kudo në TV nderimin që i bëhet sportit dhe realisht u gëzova shumë që më në fund sporti po arrin të marrë vlerat e duhura, pak vonë, por më mirë vonë se kurrë. Bashkë me gëzimin që përjetova për kolegët e mi të cilëve ua di vuajtjet sepse jemi bashkë në këtë rrugë prej vitesh kush më lart e kush më poshtë në rezultate, përjetova edhe një trishtim! Shteti im, atdheu ku unë u linda, u rrita dhe nuk u largova, edhe pse ofertat ishin të pafundme, më kishte harruar? Pse vallë? A nuk e di shteti im se kush jam unë? A nuk e di shteti im që unë Daniel Godelli i kam dhuruar atdheut tim mbi 50 medalje.



Flasim këtu për medalje ari, argjendi e bronzi. Besoj se shteti im nuk e ka harruar që unë jam i vetmi kampion bote në dygarësh që Shqipëria ka deri më sot për 20-vjeçarët", ka thënë Godelli. Më pas Godelli vijon me historinë e dopingut dhe lojën e federatës me peshëngritësit, duke thënë se vuajti dënimin dhe u rikthye si kampion më 2017. "Unë jam po ai sportist si disa nga kolegët e mi aty në podiumin e nderit sot që kemi pasur një problematikë me dopingun, por ndryshe nga ata unë provova që isha i pafajshëm dhe kurrë nuk heshta për të treguar që dopingun nuk ishte

zgjedhje e imja, por e të tjerëve. Gjithsesi, unë dënimin e vuajta të plotë dhe u riktheva më 2017 si kampion i Evropës në stilin e shkëputjes. Ua provova edhe një herë që unë rezultatet i kisha të arritura me gjak e me shpirt dhe ajo që ndodhi ishte kurban i lojërave të pista në kupolën e federatës që jo pak sportistë të shteteve të ndryshme e deklaruan dhe e faktuan edhe me një libër të botuar. Gjithsesi, pak rëndësi ka kjo tani. Çdo gjë kaloi dhe unë u riktheva sërish me mundësitë e mia si kampion i Evropës sikurse e përmenda më lart", ka shtuar Godelli.

Milwaukee, ekipi me rekordin më të mirë të sezonit, Clippersat fitojnë derbin ndaj Lakersave

MILWAUKEE, 6 PRILL - Skuadra e Milwaukeees siguron matematikisht kreun e renditjes në Konferencën e Lindjes në sezonin e rregullt. Jo vetëm kaq, por Bucksit është ekipi me rekordin më të mirë në NBA këtë sezon dhe do të ketë faktorin fushë në favor në fazën "play-off". Ata mundën me rezultat 105-92 Chicagon (Portis e Lopez 53 pikë së bashku). Pas katër fitoresh ndalet ekipi i Lakersave, që u mund me shifrat 125-118 nga Clippersat në derbin e Los Anxhelosit. LeBron Jamesi realizoi 33 pikë, por që mbetën për statistikë, ndërsa për Clippersat u dalluan Powellit me 27 pikë e Leonardo me 25. Fiton edhe



New Yorku, që falë 39 pikëve të Quickleyt, 36 të Grimesit dhe 32 të Toppinit, mundi me shifrat 138-129 Indianan. Fitore shprese arrin Dallasi, që mundi me shifrat 123-119 Sacramenton, duke qenë ende në garë për fazën "play in". Për

Rezultatet	
Detroit - Brooklyn	108-123
Indiana - New York	129-138
Atlanta - Washington	134-116
Boston - Toronto	97-93
Milwaukee - Chicago	105-92
New Orleans - Memphis	128-131
Dallas - Sacramento	123-119
Clippers - Lakers	125-118

teksanët u dalluan Irvingu me 31 pikë e Donçiqi me 29. Nuk zhgënjën Bostoni, që mundi me shifrat 97-93 Toronton (Brogdon 29 pikë), ndërsa New Orleansi mundi me shifrat 131-28 Memphisin pas kohës shtesë (Jones 35 pikë).

SHKURT

Trepça fiton në 'Minatori'

KH Trepça e ka fituar ndeshjen e xhiros së 25-të të Superligës A të Kosovës në hendboll. Të mërkurën mbrëma në "Minatori", Trepça e mposhti bindshëm Rahovecin me rezultat 34:24. Në pjesën e parë vendasit kishin epërsi prej disa golash, ndërsa në pjesën e dytë epërsia e "xehetarëve" shkoi deri në 14 gola. Me fitore, Trepça është forcur në pozitën e dytë. Rahoveci vazhdon garën për plejof.

Xavi: Kur nuk e 'vret' Realin, Reali të 'vret' ty

Barcelona pësoi humbje të thellë nga Real Madridi në ndeshjen kthyesë të gjysmëfinale së Kupës së Mbretit (0-4), duke e humbur shansin të kualifikohet në finale. Trajneri Xavi Hernandez ka thënë se kur nuk e "vret" Realin, Reali të "vret" ty. "Ne nuk jemi mjaft të pjekur. Kemi kaq shumë lojtarë të rinj dhe ata duhet të mësojnë se si të konkurrojnë më mirë. Kur nuk e vret Realin, Reali të vret ty. Ne nuk shënuam të paktën një gol. Ata ishin më të mirë se ne dhe ky është futbollit", ka thënë Xavi, i cili më pas ka thënë se, ndryshe nga edicioni i kaluar, Barcelona ka shënuar një ngritje dhe pas Superkupës është në rrugë të mirë për të fituar edhe La Ligën. "Le të kujtojmë se nga kemi ardhur. Kur mbërrita, ne nuk konkuruam për asgjë. Një vit më vonë ne mund ta fitonim La Ligën dhe ne kemi fituar Superkupën. Për mua, ky është përparim i mirë", ka shtuar Xavi.

Chelsea rikthen Lampardin

Frank Lampardi dhe Chelsea kanë arritur marrëveshje dhe legjenda e "Bluve" do të jetë trajneri i ri i klubit nga "Stemford Bridge" të paktën për dy muajt e ardhshëm. Lampard zë kështu vendin e të shkarkuarit Potter, teksa edhe vetë pësoi të njëjtin fat pak javë më parë nga Evertoni. Ky është një rikthim për Lampardin te Chelsea, pasi më herët i drejtoi në 84 ndeshje nga të cilat arriti 44 fitore, por u shkarkua pas pesë humbjeve në kampionat. Në aventurën e parë, Lampardi e dërgoi skuadrën në finalen e FA Cup. Me 14 pikë larg katër skuadrave më të mira, Chelsea e gjen veten në vendin e 11 në Premier Ligë. Debutimi i tij pritet të shtunën kundër Wolves në transfertë, para se të mërkurën e 12 prillit të përballet me Real Madridin në çerekfinalin e Ligës së Kampionëve.

Morgan: Largimi i Ronaldos, më i keqi i historisë

Gazetari anglez Piers Morgan iu kthye kritikave të ashpra ndaj vendimit të trajnerit Erik Ten Hag për ta hequr Cristiano Ronaldon dhe për të vënë bast me holandezin Wout Weghors në sulmin e Manchester Unitedit. "Dy gola të tjerë për Cristiano Ronaldon (në fitoren e fundit në Al Nassr), njëri prej tyre i mrekullueshëm, dhe kjo tregon sërish se vendimi për ta shkëmbyer me Wout Weghors ishte një nga më të këqijtë në historinë e futbollit", ka deklaruar gazetari në rrjetet sociale. Sulmuesi holandez mbërriti në merkaton e dimrit në Manchester dhe ka luajtur 19 ndeshje radhazi, por ende nuk ka shënuar në Premier Ligë. Weghorst ka gjetur dy herë rrjetën, por në garat e tjera. Ronaldo në ndeshjet me Al Nassrin dhe kombëtaren e Portugalisë ka shënuar 15 gola në 11 ndeshje.

Mourinho merr ofertë marramendëse në Arabinë Saudite


Trajneri aktual i Romës, Jose Mourinho, thuhet se ka marrë një ofertë prej 120 milionë eurosh për ta trajnuar për dy vjet Arabinë Saudite. Sipas "Corriere dello

Sport", oferta dyvjeçare, 60 milionë euro për çdo sezon, mbërriti drejtpërdrejt nga zyrtarët më të lartë të futbollit të Arabisë Saudite, për të trajnuar ose ekipin kombëtar

ose njërin klub mes Al-Nassr ose Al-Ahli. Kombëtarja e Arabisë Saudite tronditi botën me fitoren e tyre në Kupën e Botës ndaj Argentinës. Al-Nassri mori

Cristiano Ronaldon në një transferim të lirë në janar, duke e nënshkruar atë me një marrëveshje tepër fitimprurëse dyvjeçare e gjysmë. Raportet e fundit në

media sugjerojnë se ata kanë përgatitur një ofertë totale prej 400 milionë eurosh për Lionel Messin, kontrata e të cilit me Paris Saint-Germainin skadon në qershor.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo

**NJOFTIM I SHITJES ME OFERTA TË MBYLLURA
OBAVEŠTENJE O PRODAJI SA ZATVORENIM PONUDAMA**

Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Neni 34, pasuria e përshkruar më poshtë është konfiskuar për mos pagesë të tatimit, nga Mbledhja e Detyruar e Tatimit. Pasuria do të shitet me ankand të ofertave të mbyllura sikurse është rregulluar në "Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat" dhe Udhëzimin administrativ nr. 15/2010, neni 37.

Prema Zakonu br. 03 / L-222 Član 34, imovina opisana u nastavku oduzeta je zbog neplaćanja poreza, prinudnom naplatom poreza. Imovina će se prodati na aukciji zatvorenih ponuda kako je regulisano u „Zakonu 03 / L-222 o Poreska uprava i postupci “i Administrativno uputstvo br. 15/2010, član 37.

Ofertat do të hapen për herën parë (2) 20.04.2023 (Enjte) ora 11:00 Vendi i shitjes Departamenti për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve. Veternik prapa Albi Mallë ngjitur me Doganë, Rr. Hasan Hasani Nr 40- Prishtinë.

Ponude će se otvoriti po prvi put (2): 20.04.2023 (Cetfertak) u 11:00 Mesto prodaje: Odeljenje za upravljanje naplatom dugova. Veternik iza Albi Mall-a porcd Carine, ul. Hasan Hasani br. 40- Priština.

Përshkrimi i Pasurisë /Opis imovine:

1. Tokë (Kullosë e klasës IV – momentalisht ndodhen disa lloje të pemeve) ,Prona ndodhet ne fshatin PLAVË II Komuna e Dragashit ne numër te Parceles P – 70604032-00521-0 me sipërfaqe 7982 (79.82 m2)
2. **OFERTAT DO TË HAPEN : 20.04.2023**
3. **VENDI I SHITJES : ZYRAT E DMB – VETERNIK – PRISHTINË**

1. Zemlja(Pasnjak, klasa IV- momentalno na parceli se nalazi vocnjak), Zemljiste se nalazi u zvanom mestu Plava II Opština Dragas na broj parcele P – 70604032-00521-0 površine 798 (79.82 m2)
2. **Ponuda ce biti otvorena : 20.04.2023**
3. **Prodajno mesto : u Kancalariju OND – Veternikë - Prishtinë**



Kushtet e pjesëmarrjes: kushti i pjesëmarrjes në ankand, kur kemi shitje të pasurisë së paluajtshme është paradhënia (garancia bankare) në shumën 10% të detyrimeve tatimore të pa paguara të tatimpaguesit. Paraqitja e Ofertave: Të gjitha ofertat qartë duhet të identifikojnë pasurin e ofruar, shumën e ofertës, emrin, adresën dhe numrin e llogaris bankare të individit apo entitetit që paraqet ofertën, Ofertat duhet të pranohen në pliko (zarf) të mbyllur përpara datës dhe kohës të specifikuar më lartë.

/Uslovi učešća: Uslovi učešća u licitaciji, kada se radi e nepokretnoj imovini, je avans (bankarska garancija) u iznosu od 10% neisplaćenih poreskih obaveza poreskog obveznika. Dostavljanje ponuda: Sve ponude jasno identifikuju ponudjenu imovinu, iznos ponude, ime, adresu, i broj bankarskog računa pojedınca ili entiteta koji dostavlja ponudu treba da se primaju u zatvoreni pliko (koverat) pre gore specificiranog datuma i vremena .


Pasuria mund të inspektohet në çdo dite pune prej orës 9:00 deri 15:00 nga data. 05.04.2023 deri më datën 19.04.2023 dhe mund të kontaktoni personat zyrtar në tel mobil: 044-394-444; 044-982-704; 044-354-276.

Imovina može da se vidi i pregleda svakog dana u periodu od 9.00 do 15.00 casova od dana 05.04.2023 do dana 19.04.2023 i mozete kontaktirati sluzbenike na sledece brojeve telefons: 044-394-444; 044-982-704; 044-354-276.


Departamenti për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve-Prishtinë/ Odeljenje za upravljanje naplate duga-Priština **MD-029**

Zyrtar Tatimor:
Malush Kelmendi



Datë,04.04.2023



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskoo Pravde-Ministry of Justice**



Agencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom / Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 06.04.2023 **Referenca: AAPSK – 004/2023**

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	VW Kombi,ngjyre e kuqe-për skrap	1 copë/për skrap	200.00€		
2	Furgon VW 253,viti i prodhimit 1987, dizel,ngjyre e bardhë-për pjesë	1 copë/për pjesë	375.00€		
3	Ford Fokus,viti i prodhimit 2008,ngjyre e zezë,për pjesë	1 copë/për pjesë	600.00€		
4	Peugeot 406,viti i prodhimit 1999, benzin,ngjyre e kalter,me targa vendore	1 copë	800.00€		
5	Mercedes ML 270CDI, ngjyrë hiri,dizel,viti i prodhimit 2001,me targa vendore	1 copë	3,000.00€		
6	Citroen DS3 ngjyre e kuqe,viti i prodhimit 2010,benzin,automatik,me targa të huaja-për pjesë	1 copë/për pjesë	4,000.00€		
7	Audi B8 A4 ngjyre e hirit metalike,viti i prodhimit 2010, dizel,automatik, me targa vendore;	1 copë	10,000.00€		
8	Renault R Captur ngjyre e bardhë,viti i prodhimit 2018,dizel,automatik, me targa vendore	1 copë	15,000.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 13.04.2023 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 13.04.2023, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasuri e sekuestruar ose të konfiskuara në këtë procedurë shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se ,në: <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 016

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Kreshnik Dervishaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t "Nexhmedin Nixha" Elektroteknik Gjakovë.

Fatlind Dobruna nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)


KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 03.04.2023 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 07.04.2023 të shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Një (1) Punëtor Fizik -Njësia në Vushtrri me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diploma e shkollës fillore ose të mesme e preferueshme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 07.04.2023 deri më datën 21.04.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.


KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 03.04.2023 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 07.04.2023 të shpall:

KONKURS Publik

Për plotësimin e vendit të punës:

Menaxher i Njësisë Vushtrri me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Bënë menaxhimin e bartjes së mbeturinave në zonën e caktuar
- Jep urdhëresat për kryerjen punëve dhe kontrollon realizimin e tyre.
- Është përgjegjës për efikasitetin dhe kualitetin e kryerjes së shërbimeve.
- Evidenton vërejtjet e shfrytëzuesve dhe eliminon ato me urgjencë dhe efikasitet.
- Drejtpërdrejtë kontakton me shfrytëzuesit e shërbimeve në relacion të zgjidhjes së qështjeve rreth shërbimeve.
- Në bashkëpunim me kryepunëtorin plotëson urdhëresat, mban evidencën mbi deponit e egra dhe ditarin e punës.
- Në bashkëpunim me Kryepunëtorët bënë planin e shfrytëzimit të pushimit vjetor për punëtorët e zonës.
- Raporton për shfrytëzimin e orarit të punës dhe kapacitetit teknik në zonën e tij.
- Plotëson urdhëresat e orëve të punës për pagesën e të AP.përcjell zbatimin e planit operativ të shërbimeve dhe për çdo ndryshim apo mos zbatim sipas orarit të përcaktuar, e njofton me kohë udhëheqësin e drejtpërdrejtë për arsyet dhe pengesat.
- Është i obliguar që të ketë njohuri dhe evidence mbi numrin e klientve të cilëve u kryhen shërbimet dhe në bazë të këtij parametri të harmonizon Planin operativ për mekanizmin optimal teknik dhe fuqin punëtorë në operativë.
- Bashkëpunon me shërbimin me klient për të harmonizuar aktivitetet dhe iniciativat në funksion të inkasimit për shërbimet e kryera.
- Paraqet propozimet të udhëheqësi i drejtpërdrejtë për marrjen e masave për ndërprerjen e shërbimeve të klientve të caktuar që nuk paguajn obligimet,
- Merr pjesë në punën e komisioneve në rastet e ekzaminimeve të normës dhe vëllimit të kryerjes së shërbimeve dhe të hargjimeve të naftës në zonën e caktuar.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomë Universitare;
- Të posedoj së paku 3 vite përvojë profesionale ;
- CV-ja;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Letër motivimi;
- Dëshminë për përvojën e Punës (Trusti Pensional);
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Exel);
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 07.04.2023 deri më datën 21.04.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.


KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 03.04.2023 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 07.04.2023 të shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Një (1) Rojtar -Njësia në Vushtrri me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kujdeset për ruajtjen e pasurisë-objekteve dhe mjeteve themelore të Ndërmarrjes përkatësisht NP.
- Bënë shikimin e rregullt të objekteve dhe lokacionit në të cilin është i caktuar sipas orarit mujor.
- Në rast të shpërthimit të zjarrit, ndërmer masat për shuarjen dhe lajmërimin e tij.
- Përcjell gjendjen dhe ndalon çasjen e personave të panjohur në lokacionet ku nuk lejohet sjellja e personave të panjohur.
- Mban evidencën në librin e rojës për ndrimin e tij.
- Evidenton dhe kontrollon hyrjen dhe daljen e automjeteve dhe personave në oborrin e Ndërmarrjes.
- Kujdeset për ruajtjen e pasurisë dhe kryen punë tjera sipas nevojave të paraqitura në lokacionin e deponisë së mbeturinave. sipas kërkesës dhe urdhërit nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë si dhe kryen edhe punë tjera të kësaj lëmie.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën e shkollës fillore ose të mesme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 07.04.2023 deri më datën 21.04.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/giejpuneshpejte

RESTAURANT


SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



SHKOLLA E MESME E LARTË "AHMET GASHI"
Nr. 929/3, dt. 07.04.2023

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore, SHML "Ahmet Gashi" shpallë këtë:

FTESË PËR OFERTË

SHML "Ahmet Gashi" në Komunën e Prishtinës organizon ekskursionin e maturantëve të vitit shkollor 2022/2023 për në Republikën e Shqipërisë. Ftohen operatorët ekonomikë për parashtrimin e ofertave përkatëse, duke ju përmbajtur kushteve të kësaj oferte.

I. Informata të përgjithshme

1. Ftesa për ofertë mbetet e hapur shtatë (7) ditë nga data e publikimit të ftesës më dt. 07.04.2023 deri më dt. 19.04.2023;
2. Ofertat e operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojnë çmimin për nxënësit, i cili përfshinë akomodimin në hotel, fjetjen, sigurinë fizike, sigurinë shëndetësore, ushqimin cilësor dhe kalorik, shërbimin mjekësor 24 orë, transportin, shpenzimet përcelëse në monumente dhe vende historike dhe çështje të tjera specifike të kontrollimit teknik dhe personelit të agjencisë të përcaktuara në kushtet e kësaj ftese për ofertë;
3. Kohëzgjatja e ekskursionit dhe qëndrimit në Durrës do të jetë pesë (5) ditë apo katër (4) bujtje. Në ditën e pestë bëhet kthimi për në Prishtinë;
4. Numri i nxënësve maturantë që do të udhëtojnë për në Republikën e Shqipërisë do të jetë katërqind e shtatëdhjetë (470), përfshirë edhe personelin e shkollës;
5. Çështje të tjera specifike përcaktohen në kontratën midis autoritetit kontraktues (shkolla) dhe operatorit ekonomik (agjencitë);
6. Operatorët ekonomikë (agjencitë) duhet t'i përmbahen të gjitha obligimeve që përcaktohen me Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore dhe të gjitha akteve tjera ligjore/nënligjore përkatëse.

II. Kushtet

1. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë lejen e punës;
2. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë certifikatën e biznesit dhe informatat përkatëse të biznesit;
3. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë vërtetimin tatimor nga ATK;
4. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë licencën sipas Ligjit mbi transportin me të drejtë qarkullimi jashtë kufijve të Republikës së Kosovës;
5. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë bërë kontrollimin teknik të të gjithë autobusëve sipas procedurave të përcaktuara ligjore;
6. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës;
7. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë autobusët komfort dhe me klimë;
8. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i restorantit);
9. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
10. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron përkuqjesje dhe shërbime mjekësore për nxënësit gjatë tërë kohëzgjatjes së ekskursionit, diplomën dhe kontratën e punës së mjekut;
11. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron dëshmi për rezervimin e hotelit në datat e caktuara me vërtetim përkatës, i cili hotel duhet të ofron siguri 24 orë për nxënësit dhe personelin përçjellës.
12. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar të posedon licencën për aktivitete të lira dhe argëtim për nxënësit (ballo);
13. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar të mos shërben pije alkoolike;
14. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar ka shtretër të mjaftueshëm për 450 nxënës dhe të mos sistemohen më shumë se tre/katër nxënës në dhomë;
15. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar ka sallën e licencuar të ushqimit dhe ofron tre (3) porcione të plota të ushqimit;
16. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar është i rrethuar dhe krijon siguri për nxënësit;
17. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron listën e ngasësve (shoferëve) të autobusëve dhe punëtorëve që do të marrin pjesë në ekskursion;
18. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron referime tjera organizative të ekskursioneve me maturantë;
19. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron dëshmi të kushteve dhe standardeve me pamje përkatëse të hotelit të rezervuar;
20. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron të dhënat e hotelit të rezervuar, emrin dhe mbiemrin e pronarit, adresën dhe numrin kontaktues të pronarit/përgjegjësve të hotelit të rezervuar;

21. Lirimi deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike, që përcaktohet nga Këshilli organizativ i ekskursionit.

III. Dokumentet e kërkuara

1. Leja e punës së OE;
2. Certifikatën dhe informatat e biznesit së OE;
3. Vërtetimi tatimor nga ATK;
4. Licenca e transportit ndërkombëtar - D të OE;
5. Librezat e të gjithë autobusëve të OE;
6. Dëshmia e kontrollimit teknik të autobusëve;
7. Dëshmi të komfortit/klimës së autobusëve;
8. Licenca e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (vërtetim nga pronari i restorantit/hotelit);
9. Certifikata shëndetësore e ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
10. Diploma dhe Kontrata e punës së mjekut;
11. Dëshmia e rezervimit të hotelit - Vërtetim;
12. Licenca/vërtetimi i hotelit për aktivitete të lira dhe rekreative për nxënësit;
13. Vërtetimi i hotelit për mos-shërbim të pijeve alkoolike;
14. Vërtetimi i hotelit për numrin e dhomave dhe sistemimin për numrin e nxënësve për dhomë;
15. Licenca e hotelit për sallën e ushqimit në ofrimin e tre vakteve ushqimore;
16. Vërtetimi i hotelit për sigurinë e nxënësve;
17. Lista e ngasësve me licencën D për transport ndërkombëtar;
18. Dëshmi tjera organizative të ekskursioneve përkatëse;
19. Fotografi dhe dëshmi të standardeve dhe kushteve të hotelit të rezervuar;
20. Konfirmim me të dhënat e vendndodhjes së hotelit dhe të dhënat e pronarit të hotelit.
21. Deklarata për lirim nga pagesa deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike.

IV. Dorëzimi i dokumenteve

1. Ftesa për ofertë do të jetë e hapur shtatë (7) dita nga data e publikimit të ftesës për ofertë më 07.04.2023 deri më dt. 19.04.2023;
2. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në zarf të mbyllur në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës me protokoll zyrtar, në sportelin nr. 5, drejtuar Drejtorisë së Arsimit të Komunës të Prishtinës;
3. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje të noterizuara;
4. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
5. Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të dorëzuara bëhet nga Komisioni përkatës në Drejtorinë e Arsimit, duke respektuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
6. Ofertuesi i përzgjedhur merr të gjitha obligimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Priština
SHML "EQREM ÇABEJ" në Prishtinë



Shkolla e Mesme e Lartë "EQREM ÇABEJ"

Nr. i prot.: 232/2

Më 07.04.2023

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore, SHML "EQREM ÇABEJ" shpallë këtë:

FTESË PËR OFERTË

SHML "EQREM ÇABEJ" në Komunën e Prishtinës organizon ekskursionin e maturantëve të vitit shkollor 2022-2023 për në Republikën e Shqipërisë. Ftohen operatorët ekonomikë për parashtrimin e ofertave përkatëse, duke ju përmbajtur kushteve të kësaj oferte.

I. Informata të përgjithshme

1. Ftesa për ofertë mbetet e hapur shtatë (7) ditë nga data e publikimit të ftesës, më 07.04.2023 deri, më 14.04.2023;
2. Ofertat e operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojnë çmimin për nxënës, i cili përfshinë akomodimin në hotel, fjetjen, sigurimin fizik, sigurimin shëndetësor, ushqimin cilësor dhe kalorik, shërbimin mjekësor 24 orë, transportin, shpenzimet përcellëse gjatë vizitës së monumenteve dhe vendeve historike dhe çështje të tjera specifike të kontrollimit teknik dhe personelit të agjencisë të përcaktuara në kushtet e kësaj ftese për ofertë;
3. Kohëzgjatja e ekskursionit dhe qëndrimit në Durrës do të jetë pesë (5) ditë apo katër (4) bujtje. Në ditën e pestë bëhet kthimi për në Prishtinë;
4. Numri i nxënësve maturantë që do të udhëtojnë për në Republikën e Shqipërisë do të jetë **dyqind (200)**, përfshirë edhe personelin e shkollës;
5. Çështje të tjera specifike përcaktohen në kontratën midis autoritetit kontraktues (shkolla) dhe operatorit ekonomik (agjencisë);
6. Operatorët ekonomikë (agjencitë) duhet t'i përmbahen të gjitha obligimeve që përcaktohen me Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitetet jashtëshkollore dhe të gjitha akteve tjera ligjore/nënligjore përkatëse.

II. Kushtet

1. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë lejen e punës;
2. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë certifikatën e biznesit dhe informatat përkatëse të biznesit;
3. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë vërtetimin tatimor nga ATK;
4. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë licencën sipas Ligjit mbi transportin me të drejtë qarkullimi jashtë kufijve të Republikës së Kosovës;
5. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë bërë kontrollimin teknik të të gjithë autobusëve sipas procedurave të përcaktuara ligjore;
6. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës;
7. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë autobusët komfort dhe me klimë;
8. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i restorantit);
9. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
10. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të sigurojë përkujdesje dhe shërbime mjekësore për nxënësit gjatë tërë kohëzgjatjes së ekskursionit, diplomën dhe kontratën e punës së mjekut;
11. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të sigurojë **dëshmi për rezervimin e hotelit** në datat e caktuara me vërtetim përkatës, i cili hotel duhet të ofrojë siguri 24 orë për nxënësit dhe personelin përcjellës.
12. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofrojë dëshmi se hoteli i rezervuar posedon licencën për aktivitete të lira dhe argëtim për nxënësit (ballo);
13. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofrojë dëshmi se hoteli i rezervuar të mos shërbejë pije alkoolike;
14. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofrojë dëshmi se hoteli i rezervuar ka shtretër të mjaftueshëm për **200 nxënës** dhe të mos sistemohen më shumë se **tre/katër nxënës** në dhomë;
15. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofrojë dëshmi se hoteli i rezervuar ka sallën e licencuar të ushqimit dhe ofron tre (3) racione të plota të ushqimit;
16. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofrojë dëshmi se hoteli i rezervuar është i rrethuar dhe krijon siguri për nxënësit;
17. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofrojë listën e ngasësve (shoferëve) të autobusëve dhe punëtorëve që do të marrin pjesë në ekskursion;
18. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofrojë referime tjera organizative të ekskursioneve me maturantë;
19. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të sigurojë dëshmi të kushteve dhe standardeve me pamje përkatëse të hotelit të rezervuar;
20. Operatori ekonomik (agjencia) duhet të sigurojë të dhënat e hotelit të rezervuar, emrin dhe mbiemrin e pronarit, adresën dhe numrin kontaktues të pronarit/përgjegjësve të hotelit të rezervuar;
21. **Lirim deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike**, që përcaktohet nga Këshilli organizativ i ekskursionit.

III. Dokumentet e kërkuara

1. Leja e punës së OE;
2. Certifikatën dhe informatat e biznesit së OE;
3. Vërtetimi tatimor nga ATK;
4. Licenca e transportit ndërkombëtar - D të OE;
5. Librezat e të gjithë autobusëve të OE;
6. Dëshmia e kontrollimit teknik të autobusëve;
7. Dëshmi të komfortit/klimës së autobusëve;
8. Licenca e agjencisë së akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (vërtetim nga pronari i restorantit/hotelit);
9. Certifikata shëndetësore e ngasësve (shoferëve) të autobusëve;
10. Diploma dhe Kontrata e punës së mjekut;
11. Dëshmia e rezervimit të hotelit - Vërtetim;
12. Licenca/vërtetimi i hotelit për aktivitete të lira dhe rekreative për nxënësit;
13. Vërtetimi i hotelit për mos-shërbim të pijeve alkoolike;
14. Vërtetimi i hotelit për numrin e dhomave dhe sistemimin për numrin e nxënësve për dhomë;
15. Licenca e hotelit për sallën e ushqimit në ofrimin e tri racioneve ushqimore;
16. Vërtetimi i hotelit për sigurinë e nxënësve;
17. Lista e ngasësve me licencën D për transport ndërkombëtar;
18. Dëshmi tjera organizative të ekskursioneve përkatëse;
19. Fotografi dhe dëshmi të standardeve dhe kushteve të hotelit të rezervuar;
20. Konfirmim me të dhënat e vendndodhjes së hotelit dhe të dhënat e pronarit të hotelit.
21. Deklarata për lirim nga pagesa deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike.

IV. Dorëzimi i dokumenteve

1. Ftesa për ofertë do të jetë e hapur shtatë (7) dita nga data e publikimit të ftesës për ofertë më 07.04.2023 deri, më 19.04.2023;
2. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në zarf të mbyllur në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës me protokoll zyrtar, në sportelin nr. 5, drejtuar Drejtorisë së Arsimit të Komunës të Prishtinës;
3. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje të noterizuara;
4. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e pakompletuara refuzohen;
5. Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të dorëzuara bëhet nga Komisioni përkatës në Drejtorinë e Arsimit, duke respektuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
6. Ofertuesi i përzgjedhur merr të gjitha obligimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË PULE

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues